



RAPORTI I ARRITJEVE

ASCAP

SHTATOR 2017 – DHJETOR 2020

—

TABELA E PËRMBAJTJES

TABELA E PËRMBAJTJES	1
PARATHËNIE	3
HYRJE	5
I. REFORMA E KURRIKULËS	7
1.1 Vijueshmëria e reformës së kurrikulës me kompetenca.....	7
1.1.1 Arsimi parashkollor	7
1.1.2 Arsimi bazë	9
1.1.3 Arsimi i mesëm i lartë.....	10
1.2 Hartimi i programeve lëndore	12
1.3 Udhëzuesit dhe materialet në ndihmë të mësuesve	13
1.4 Nisma të ndërmarra	15
1.1.4 Nisma “Tri lëndë në gjashtë orë”	15
1.1.5 Nisma “Bëjmë detyrat e shtëpisë në shkollë”	17
1.1.6 Analiza e vlerësimit të kurrikulës së AMU-së dhe të AML-së.....	18
II. ZHVILLIMI PROFESIONAL I MËSUESVE	20
2.1 Formimi fillestar i mësuesve	20
2.2 Zhvillimi i vazhdueshëm profesional i punonjësve arsimorë.....	22
2.3 Drejtuesit e rrjeteve të shkencave të natyrës	25
2.4 Zhvillimi profesional i mësuesve të gjuhës shqipe e të letërsisë, si dhe të matematikës për vlerësimin e nxënësve që bazohet në kompetenca dhe për përgatitjen për provimet kombëtare të MSH-së	26
2.5 Funksionimi i komisionit të akreditimit të programeve/moduleve të trajnimit (KAPT), si dhe funksionimi i portalit	27
2.6 Trajnimi i mësuesve nga agjencitë e akredituara sipas portalit të trajnimeve.....	29
2.7 Kualifikimi i mësuesve.....	30
2.8 Standardet profesionale të mësuesit dhe identifikimi i nevojave për trajnim të mësuesve	32
2.9 Teknologjia në procesin e mësimdhënie – nxënies	36
III. PËRBALLIMI I SITUATËS SË KRIJUAR NGA TËRMETI I 26 NËNTORIT 2019, SI DHE NGA PANDEMIA COVID- 19.....	39
3.1 Roli ASCAP-it në përballimin e situatës së krijuar nga tërmeti i 26 nëntorit 2019.....	39
3.2 Roli ASCAP-it në përballimin e situatës së krijuar nga pandemia COVID- 19	40

IV. NGRITJA E KAPACITETEVE TË MËSUESVE NDIHMËS, TË SHËRBIMIT PSIKO-SOCIAL DHE TË OFICERËVE TË SIGURISË.....	42
4.1 Ngritja e kapaciteteve të mësuesve ndihmës.....	42
4.2 Ngritja e kapaciteteve të shërbimit psiko-social dhe të oficerëve të sigurisë.....	43
V. NGRITJA E SISTEMIT TË VLERËSIMIT TË PERFORMANCËS SË SISTEMIT TË ARSIMIT PARAUNIVERSITAR	45
VI. FUQIZIMI I SIGURIMIT TË CILËSISË SË ARSIMIT PARAUNIVERSITAR	46
VII. DIASPORA DHE PAKICAT KOMBËTARE.....	52
7.1 Regjistri i diasporës.....	52
7.2 Mbështetja dhe organizimi i seminarit të përvitshëm me mësues nga diaspora	53
7.3 Pakicat kombëtare	55
VIII. RRITJA E PARTNERITETIT DHE E BASHKËPUNIMIT ME INSTITUCIONE E ORGANIZMA TË TJERË QEVERITARË DHE JO QEVERITARË, TË BRENDSHËM E TË HUAJ, NË FUNKSION TË REALIZIMIT TË OBJEKTIVAVE TË POLITIKËS DHE TË REFORMËS ARSIMORE.....	56
8.1 Mbështetja teknike pranë MASR-së	56
8.2 Bashkëpunimi me institucione dhe organizata të tjera.....	57
IX. KONFERENCA DHE PJESEMARRJE.....	66
X. STUDIME SHKENCORE DHE BOTIME	67

PARATHËNIE

Agjencia e Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar (ASCAP) është krijuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 98, datë 27.02.2019 “Për krijimin dhe mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar”, mbi bazën e Institutit të Zhvillimit të Arsimit (IZHA) dhe të Inspektoratit Shtetëror të Arsimit (ISHA).

Instituti i Zhvillimit të Arsimit u krijua në mars të vitit 2010, si institucion publik në varësi të ministrit të Arsimit dhe të Shkencës, mbi bazën e Institutit të Kurrikulës dhe të Trajnimit. Historiku i këtij institucioni me attribute ekspertimi, këshillimi dhe studimi në arsim, nis shumë më herët, që nga viti 1965, kur instituti u emërtua si Instituti i Studimeve Pedagogjike.

Inspektorati Shtetëror i Arsimit u krijua në 03.04.2013, si institucion publik në varësi të ministrit të Arsimit dhe të Shkencës, mbi bazën e Inspektoratit Kombëtar të Arsimit Parauniversitar, i cili u krijua në mars të vitit 2010.

ASCAP është person juridik publik, në varësi të ministrit të Arsimit dhe të Sportit, me seli në rrugën “Naim Frashëri”, nr. 37, Tiranë.

ASCAP është anëtare me të drejta të plota e disa rrjeteve ndërkombëtare si CIDREE (Consortium of Institutions for Development and Research in Education in Europe) dhe Global Education. Ajo ka disa detyra dhe përgjegjësi në rrjete, si pjesëmarrjen në projekte të përbashkëta dhe ndjekjen e takimeve dhe të konferencave të përvitshme, ku raporton për zhvillimet akademike të arsimit parauniversitar në Shqipëri.

Misioni dhe fushat e përgjegjësisë së ASCAP-it

Misioni i ASCAP-it është të garantojë cilësinë e arsimit parauniversitar publik e privat, në përputhje me qasjen e kurrikulës së bazuar në zhvillimin e kompetencave.

Fushat e përgjegjësisë së ASCAP-it janë:

- a) garantimi dhe vlerësimi i performancës së sistemit arsimor parauniversitar publik dhe privat;
- b) zhvillimi i kurrikulës dhe zhvillimi profesional i punonjësve në arsimin parauniversitar publik dhe privat;
- c) sigurimi i cilësisë së arritjeve në arsimin parauniversitar publik dhe privat.

ASCAP ka përgjegjësi:

- a) të organizojë punën për vlerësimin e performancës së sistemit arsimor parauniversitar publik dhe privat;
- b) të organizojë zhvillimin profesional dhe kualifikimin e punonjësve në arsimin parauniversitar publik dhe privat;
- c) të monitorojë sigurimin e cilësisë dhe vlerësimin e institucioneve të arsimit parauniversitar publik dhe privat, si dhe programet e tyre mësimore;
- d) të sigurojë zhvillimin e kurrikulës në arsimin parauniversitar publik dhe privat.

Veprimtaritë e planifikuara dhe të realizuara nga ASCAP gjatë periudhës shtator 2017–dhjetor 2020, kanë pasur dhe kanë për qëllim ofrimin e zgjidhjeve afatshkurtra e afatgjata në fusha e aspekte të ndryshme të arsimit. Ato burojnë nga projekte të nxitura nga Strategjia e Zhvillimit të Arsimit Parauniversitar 2014-2020, përparësitë e politikës arsimore të qeverisë dhe nevojat e realitetit arsimor shqiptar.

HYRJE

Politikat arsimore vënë theksin në zhvillimin e një arsimi që t'i shërbejë interesit më të mirë të nxënësve dhe në sigurimin e një arsimi cilësor dhe të barabartë për çdo pjesëtar të shoqërisë, pavarësisht nga përkatësia etnike, seksi, pozita shoqërore dhe ndryshime të tjera.

Mënyrat e mësimdhënies dhe gjërat që u mësojmë fëmijëve tanë, duhet të jenë diçka unike në mënyrë që ata të kuptojnë se njerëzit janë të ndryshëm, që ata zotërojnë aftësi të cilat bazohen në qëndrime, sjellje, mendim të pavarur, punë në grup, kujdes për të tjerët, kërkim, krijimtari etj. Këto janë vlera, të cilat nuk mund të t'i mësojë vetëm dija. Në këtë këndvështrim motoja që na ka udhëhequr në punën tonë për të ndryshuar qasjen e të nxënësve në sistemin e arsimit parauniversitar është: ***“Mësuesi me dhe për nxënësin, jo mësuesi përballë nxënësit”***.

Për të ofruar një pasqyrë të qartë të veprimtarisë së ASCAP-it gjatë periudhës shtator 2017- dhjetor 2020, është hartuar ky raport, i cili përfaqëson angazhimin maksimal për jetësimin dhe përmbushjen e përparësive të politikës arsimore në vendin tonë.

Ky raport sintetik pasqyron:

- **së pari**, çfarë është arritur në një periudhë gati 3-vjeçare, në fushat kryesore të përgjegjësisë së ASCAP-it;
- **së dyti**, çfarë është konsoliduar dhe mund të shërbejë si bazë për të garantuar zhvillimet e parashikuara në plan afatgjatë dhe për të shkuar më tej drejt realizimit të objektivave.

Çështjet kryesore që trajtohen në raport janë:

I. Reforma e kurrikulës

II. Zhvillimi profesional i mësuesve

III. Roli i ASCAP-it në përballimin e situatës së krijuar nga tërmeti i 26 nëntorit 2019, si dhe të situatës së krijuar nga pandemia COVID- 19

IV. Fuqizimi i mësuesve ndihmës, i shërbimit psiko-social dhe i oficerëve të sigurisë

V. Ngritja e sistemit të vlerësimit të performancës së sistemit arsimor parauniversitar

VI. Fuqizimi i sigurimit të cilësisë së arsimit parauniversitar

VII. Rritja e partneritetit dhe e bashkëpunimit me institucione e organizma të tjerë qeveritarë dhe jo qeveritarë, të brendshëm e të huaj, në funksion të realizimit të objektivave të politikës dhe të reformës arsimore

Sfidat me të cilat është përballur shoqëria dhe institucionet në vendin tonë, sidomos gjatë dy viteve të fundit, kanë qenë sfida të mëdha edhe për ASCAP-in. Tërmeti i nëntorit të vitit 2019 dhe pandemia COVID-19 dëshmuar se ASCAP ofron zgjidhje për sistemin arsimor edhe në kohë krize, jetëson objektivat e Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë (MASR), mbështet vazhdimisht shkollat për realizimin cilësor të procesit mësimor dhe promovon risi që janë në koherencë me politikat arsimore europiane dhe me gjerë.

I. REFORMA E KURRIKULËS

1.1 Vijueshmëria e reformës së kurrikulës me kompetenca

Në shtatorin e vitit 2013, MASR ndërmori reformën kurrikulare në arsimin parauniversitar. Kurrikula e reformuar e arsimit parauniversitar ka në themel të saj aftësimin e nxënësit për jetën dhe për të nxënëit gjatë gjithë jetës.

ASCAP është një nga aktorët kryesorë që ka luajtur dhe luan një rol thelbësor në hartimin dhe në zbatimin e kësaj reforme.

Gjatë periudhës 2017-2020, në vazhdimësi të zhvillimit të reformës kurrikulare, ka vijuar zbatimi i kurrikulës me bazë kompetencat në të gjitha nivelet e arsimit parauniversitar: arsimi parashkollor, arsimi bazë dhe arsimi i mesëm i lartë.

1.1.1 Arsimi parashkollor

Në arsimin parashkollor janë hartuar dhe janë miratuar një sërë dokumentesh dhe materialesh në ndihmë të zbatimit të kurrikulës së re.

- *Programet e arsimit parashkollor (programet e grupit të fëmijëve 3-4 vjeç, programet e grupit të fëmijëve 4-5 vjeç, programet e grupit të fëmijëve 5-6 vjeç)*

Programet e reja të arsimit parashkollor janë ndërtuar mbi qasjen me kompetenca dhe janë në koherencë me ciklet dhe shkallët e tjera të kurrikulës.

- *Standardet profesionale të formimit të përgjithshëm të mësuesit të arsimit parashkollor*

Dokumenti i standardeve profesionale të mësuesit ka për qëllim kryesor të japë një vizion të ri për mësimdhënien, me fokus plotësimin e nevojave dhe të interesave individuale të çdo fëmije parashkollor. Standardet profesionale të mësuesit përshkruajnë atë që pritet të njohë, të përmbushë dhe të demonstrojë mësuesi i arsimit parashkollor duke mbrojtur personalitetin e mësuesit cilësor dhe duke ndikuar ndjeshëm në rritjen e përkushtimit të tij për profesionin që ushtron.

➤ *Korniza e vlerësimit në arsimin parashkollor*

Korniza e vlerësimit në arsimin parashkollor është hartuar për të mbështetur specialistët, mësuesit dhe stafin e kopshtit në vlerësimin e zhvillimit dhe të të nxëniet të fëmijëve parashkollorë, të moshës 3-6-vjeçare. Në fëmijërinë e hershme vlerësimi ka peshë të rëndësishme dhe përdoret si mjet për të mbështetur të nxënë të fëmijëve. Nëpërmjet vlerësimit mund të identifikohen fëmijët që mund të jenë në rrezik ose mund të kenë nevojë për ndërhyrje të hershme dhe për shërbime të arsimit të specializuar.

➤ *Standardet e zhvillimit dhe të të nxëniet për fëmijët 0-3 vjeç*

Standardet e zhvillimit dhe të të nxëniet të foshnjërisë dhe të fëmijërisë së hershme janë hartuar për fëmijët e moshës 0-3 vjeç. Këto standarde referojnë dhe përshkruajnë tregues të zhvillimit fizik, social, emocional, njohës, si dhe sjelljet, aftësitë dhe njohuritë që fëmijët e kësaj grup-moshe pritet të kenë dhe të shfaqin. Standardet përcaktojnë çfarë *mund* dhe çfarë *janë në gjendje të bëjnë, të thonë dhe të demonstrojnë* fëmijët gjatë rritjes, zhvillimit dhe kalimit nga njëra grup-moshë në tjetrën.

1.1.2 Arsimi bazë

- Zbatimi i kurrikulës së reformuar ka vijuar me procesin e pilotimit. *Gjatë viteve shkollare 2016-2017, 2017-2018, 2018-2019 u pilotuan programet e klasave të katërta, të pesta dhe të nënta, në 26 shkolla të vendit (13 shkolla në qytet dhe 13 në fshat). Ky proces, përveçse i shërbeu testimit të draft-programeve të këtyre klasave, rriti edhe pjesëmarrjen e mësuesve, deri në partneritet, në procesin e përmirësimit të tyre. Në të njëjtën kohë, pjesëmarrja në pilotim iu dha mësuesve mundësinë që të ndihen bashkautorë të programeve mësimore dhe të trajnohen për zbatimin më të mirë të tyre në praktikë.*
- Veprimtaritë e realizuara gjatë pilotimit, në periudhën 2017 – 2020, përfshinë:
 - *përgatitjen e materialeve trajnuese për mësuesit e shkollave pilot në lidhje me zbatimin e programeve lëndore, planifikimin e procesit mësimor dhe vlerësimin e nxënësve;*
 - *ngritjen e kapaciteteve të DRAP-eve, ZVA-ve, drejtuesve dhe mësuesve të shkollave pilot për procesin e pilotimit. Rreth 480 mësues të 26 shkollave pilot u trajnuan çdo vit nga specialistët e ASCAP-it, në lidhje me kurrikulën e re dhe ky grup krijoi rrjetin e trajnerëve;*
 - *monitorimin e procesit të pilotimit përmes vëzhgimeve periodike të përmuajshme, konsultimeve, takimeve, komunikimeve online dhe shkëmbimit të përvojave ndërmjet shkollave;*
 - *vlerësimin e procesit të pilotimit për përmirësimin e paketës kurrikulare, proces i cili përfshiu hartimin dhe përdorimin e instrumenteve të vlerësimit, vëzhgimet e drejtpërdrejta të procesit mësimor, studimin/analizën e të dhënave të pilotimit të kurrikulës.*
- ***Në vitin shkollor 2019-2020 filloi zbatimi i kurrikulës me kompetenca në të gjitha klasat I-IX, përfshirë edhe klasën përgatitore.*** Aktualisht kurrikula me bazë kompetencat po zbatohet në të gjitha klasat e arsimit bazë.

- Në mbështetje të punës së mësuesve dhe të drejtuesve, për zbatimin cilësor të kurrikulës në arsimin bazë, ka vijuar puna për plotësimin e mëtejshëm të paketës kurrikulare me dokumentacionin kurrikular të nevojshëm, si *programe mësimore lëndore, udhëzime dhe materiale mbështetëse në ndihmë të mësuesve dhe shkollave* (informacion më i detajuar jepet në rubrikat 1.3 dhe 1.4 të raportit).
- Është zhvilluar më tej *fuqizimi i kapaciteteve të mësuesve dhe drejtuesve të shkollave* për zbatimin me efikasitet të kurrikulës së reformuar. Në funksion të këtij qëllimi i është dhënë një fokus i veçantë trajnimit dhe nxitjes së *punës së rrjeteve profesionale të mësuesve*, si një mekanizëm që mbështet zhvillimin profesional të mësuesve dhe përmirëson cilësinë e kurrikulës së zbatuar në shkollë.
- Procesi i zbatimit të kurrikulës është shoqëruar me monitorimin dhe mbështetjen e vazhdueshme të mësuesve dhe të shkollave nga ASCAP. Për këtë qëllim *gjatë periudhës së pilotimit dhe në vazhdim*, nga specialistët e ASCAP-it janë zhvilluar takime të vazhdueshme me mësues, drejtues dhe specialistë të drejtorive arsimore, në lidhje me vlerësimin e ecurisë së zbatimit të kurrikulës, identifikimit të problematikave, mbështetjes së mësuesve dhe drejtuesve, si dhe evidentimit dhe shkëmbimit të përvojave pozitive.

1.1.3 Arsimi i mesëm i lartë

Përgjatë periudhës 2017-2020 ka vijuar zbatimi i kurrikulës më bazë kompetencat në të gjitha klasat e këtij niveli shkollimi.

- Janë hartuar dhe miratuar *programet mësimore për të gjitha klasat dhe lëndët* e kurrikulës bërthamë dhe me zgjedhje, të cilat kanë hyrë në zbatim gradualisht vit pas viti (informacion më i detajuar jepet në rubrikën 1.3 të raportit).

- Është vijuar më tej puna për sigurimin e mbështetjes me materiale ndihmëse burimore për mësuesit, rrjetet profesionale të mësuesve dhe drejtuesit e shkollave. Këtij qëllimi i ka shërbyer përgatitja e *udhëzuesve kurrikularë lëndorë për të gjitha lëndët*, përgatitja e udhëzimeve të veçanta për çështje të përgjithshme dhe specifike të lidhura me zbatimin e kurrikulës etj. (informacion i detajuar jepet në rubrikën 1.4 të raportit).
- Është mbështetur në mënyrë të vazhdueshme *trajnimi i mësuesve, drejtuesve dhe specialistëve* të njësive arsimore vendore për zbatimin me efektivitet të kurrikulës së reformuar dhe monitorimin e cilësisë së zbatimit të saj.
- Është nxitur dhe fuqizuar më tej puna për *monitorimin dhe vlerësimin e cilësisë së zbatimit të kurrikulës në gjimnaze*, përmes takimeve formale dhe informale, vëzhgimeve të orëve mësimore në shkolla, vlerësimeve online etj.

Hartimi dhe zbatimi i kurrikulës me kompetenca në të gjithë arsimin parauniversitar është shoqëruar me një proces *konsultimi të vazhdueshëm* me mësues dhe drejtues të institucioneve arsimore parauniversitare, specialistë të njësive arsimore vendore, përfaqësues të këshillave të prindërve, pedagogë të fakulteteve të edukimit, Këshillin Kombëtar të Arsimit Parauniversitar, organizatat partnere etj.

Kontribues kryesorë në përgatitjen e programeve mësimore, materialeve burimore dhe udhëzimeve shpjeguese kanë qenë *grupet e punës* të ngritura pranë ASCAP-it, të përbëra nga specialistë të ASCAP-it, specialistë të tjerë të arsimit, mësues e drejtues shkollash, pedagogë të fakulteteve të edukimit etj.

1.2 Hartimi i programeve lëndore

Gjatë periudhës 2017-2020, ASCAP në bashkëpunim me grupet e punës, të përbëra nga specialistë të arsimit, mësues dhe pedagogë – përfaqësues të fakulteteve të edukimit, ka hartuar rreth 700 programe mësimore për lëndë, klasa dhe profile të ndryshme shkollash, si më poshtë vijon:

- ▢ Finalizimi i 36 programeve lëndore të klasave IV,V dhe IX, duke u bazuar në gjetjet dhe në përfundimet e procesit të pilotimit.
- ▢ Hartimi i 19 programeve lëndore të gjimnazit për klasën e dymbëdhjetë të kurrikulës bërthamë dhe me zgjedhje.
- ▢ Hartimi i 130 programeve lëndore të kulturës së përgjithshme për shkollat profesionale dhe me drejtim të orientuar (përfshirë kulturën profesionale).
- ▢ Hartimi i 124 programeve orientuese të Vlerësimit të Arritjeve të Nxënësve në Arsimin Fillor (VANAF), Provimeve Kombëtare të Arsimit Bazë (PKAB) dhe Maturës Shtetërore (MSH) si më poshtë:
 - 16 programe orientuese të lëndëve: Gjuhë shqipe, Gjuhë e huaj dhe Matematikë, për VANAF-in, për vitet shkollore 2017, 2018, 2019, 2020.
 - 21 programe orientuese të lëndëve: Gjuhë shqipe, Gjuhë angleze, Gjuhë gjermane, Gjuhë italiane, Gjuhë frënge dhe Matematikë, për PKAB-në, për vitet shkollore 2017, 2018, 2019 dhe 2020.
 - 49 programe orientuese për lëndët e provimeve të detyruara dhe të provimit me zgjedhje të MSH-së 2017, 2018, 2019 dhe 2020.
 - 48 programe orientuese për lëndët e provimeve të detyruara të MSH-së 2017, 2018, 2019, 2020, për shkollat profesionale, për shkollat me drejtim të orientuar artistik dhe sportiv, për shkollat me drejtim të orientuar gjuhësor.
 - 20 programe orientuese për lëndët e provimeve të detyruara dhe të provimit me zgjedhje të MSH-së 2019, të rishikuara dhe të përshtatura për shkak të situatës së krijuar nga pandemia COVID-19.

☞ Hartimi i 88 programeve të shkollave të veçanta të arsimit bazë, përkatësisht të institucioneve të arsimit bazë për fëmijët e ngjuar, arsimit bazë me kohë të pjesshme, arsimit bazë në institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale për të mitur, arsimit bazë të shansit të dytë.

☞ Përgatitja e përmbledhjeve të 266 programeve mësimore të lëndëve të gjimnazit dhe programeve të lëndëve të kulturës së përgjithshme së arsimit profesional, si më poshtë:

- Përmbledhja e 29 programeve mësimore të lëndëve të gjimnazit, të zhvilluara para vitit 2007.
- Përmbledhja e 66 programeve mësimore të lëndëve të gjimnazit, të zhvilluara në vitet 2007-2016.
- Përmbledhja e 38 programeve mësimore të lëndëve të gjimnazit, të zhvilluara në vitet 2016 e në vazhdim.
- Përmbledhja e 29 programeve mësimore të lëndëve të kulturës së përgjithshme në arsimin e mesëm profesional, të zhvilluara para vitit 2007.
- Përmbledhja e 66 programeve mësimore të lëndëve të kulturës së përgjithshme në arsimin e mesëm profesional, të zhvilluara në vitet 2007-2016.
- Përmbledhja e 38 programeve mësimore të lëndëve të kulturës së përgjithshme në arsimin e mesëm profesional, të zhvilluara në vitet 2016 e në vazhdim.

1.3 Udhëzuesit dhe materialet në ndihmë të mësuesve

Zbatimi i një kurrikule të re është shumë më tepër se prezantimi i saj para drejtuesve dhe mësuesve në shkollë. Që kurrikula të jetë e suksesshme, hartuesit e saj duhet të ofrojnë mbështetje të vazhdueshme për të lehtësuar procesin e zbatimit. Në këtë kuadër drejtorja e kurrikulës dhe e kualifikimit në ASCAP, gjatë periudhës 2017-2020, ka vijuar të hartojë udhëzues dhe materiale ndihmëse, të cilat orientojnë dhe ndihmojnë shkollat (drejtuesit dhe mësuesit) në zbatimin e

kurrikulës me bazë kompetencat. Po kështu, kjo drejtori ka hartuar udhëzues për përballimin e situatave të krijuara nga tërmeti i 26 nëntorit 2019, si dhe nga pandemia COVID-19.

Kështu, përgjatë këtyre tri viteve janë hartuar materiale që ofrojnë udhëzime në lidhje me planifikimin e kurrikulës në nivel shkolle, planifikimin e mësimdhënies nga mësuesi dhe vlerësimin e nxënësve, si:

- *Udhëzuesi për zhvillimin e kurrikulës së re në arsimin e mesëm të ulët, 2017*
- *Udhëzuesi për zhvillimin e kurrikulës së re në arsimin fillor, 2019*
- *Udhëzuesi për kurrikulën me zgjedhje në gjimnaz, 2018*

Janë hartuar 26 udhëzues kurrikularë lëndorë për të gjitha lëndët në dy nivelet e arsimit parauniversitar: arsimin e mesëm të ulët (AMU) dhe arsimin e mesëm të lartë (AML).

- *Për AMU- në janë hartuar 13 udhëzues kurrikularë lëndorë*
- *Për AML- në janë hartuar 13 udhëzues kurrikularë lëndorë*

Për vlerësimin e nxënësve janë hartuar këto dokumente dhe materiale ndihmëse për shkollat:

- *Vlerësimi i nxënësit në AMU dhe në AML (material shpjegues në ndihmë të shkollave), 2019*
- *Modele testesh që vlerësojnë kompetencat, 2019*

Për zbatimin e kurrikulës në shkollat që kanë klasa kolektive, është hartuar:

- *Udhëzuesi për klasat kolektive, 2018*

Për t'u ardhur në ndihmë mësuesve në procesin e përzgjedhjes së teksteve shkollore është hartuar:

- *Udhëzuesi për përzgjedhjen e teksteve në shkollë, 2019*

Për të orientuar shkollat për vijimin e procesit mësimor në zonat e dëmtuara nga tërmeti i 26 nëntorit 2019, janë hartuar:

- *Udhëzuesi për zhvillimin e procesit mësimor në hotelet ku janë akomoduar fëmijët e zonave të dëmtuara nga tërmeti*
- *Udhëzuesi për rifillimin e procesit mësimor në shkollë, pas tërmetit të 26 nëntorit, në DRAP Durrës dhe në DRAP Lezhë*

Për të kontribuar në përgatitjen e shkollave që të jenë fleksibël në planifikimin dhe në organizimin e procesit mësimor, të gatshme për t'u ofruar nxënësve mjedise të sigurta duke respektuar rregullat e distancimit fizik dhe masat e tjera mbrojtëse, si dhe të afta për t'u përballur me pasojat e pandemisë COVID-19, janë hartuar:

- *Udhëzuesi për vlerësimin e nxënësve gjatë mëimit në distancë dhe për mbylljen e vitit shkollor 2019-2020*
- *Udhëzuesi për fillimin e vitit shkollor 2020-2021*
- *Udhëzuesi për zbatimin e programit plotësues për lëndët “Gjuhë shqipe” dhe “Matematikë” në klasat 1-5*

Materialet ndihmëse dhe udhëzuesit e mësipërm janë tregues që ASCAP i orienton dhe mbështet institucionet arsimore parauniversitare në të gjitha reformat dhe sfidat me të cilat ato përballen.

1.4 Nisma të ndërmarra

1.1.4 Nisma “Tri lëndë në gjashtë orë”

Për t'u krijuar më shumë mundësi fëmijëve tanë të rrisin *ndërveprimin në klasë, të angazhohen dhe të përfshihen* më shumë në veprimtari, të demonstrojnë më së miri dhe të zhvillojnë aftësitë e tyre, mori udhë zbatimi i nismës “Tri lëndë në gjashtë orë”. Zbatimi i kurrikulës me kompetenca kërkonte një qasje të re të organizimit të procesit të mësimdhënies, të vlerësimit të arritjeve të nxënësve dhe të menaxhimit të procesit mësimor në

shkollë. Zbatimi i punës në grup, puna e pavarur, nxitja e ndërveprimit, diskutimi i nxënësve në klasë etj., mund të zhvillohen më shumë me organizimin e orëve të njëpasnjëshme (45 min + 45 min), duke krijuar mundësi për përmirësimin e procesit të të nxënës, si dhe për rritjen e fleksibilitetit të shkollës në menaxhimin dhe në organizimin e orarit mësimor. Në kuadër të kësaj nisme u realizuan këto veprimtari:

- U hartua një udhëzues për zbatimin e nismës “Tri lëndë në gjashtë orë”. Ky udhëzues u hartua nga specialistë të kurrikulës në IZHA (sot ASCAP) dhe u konsultua me specialistë të MASR-së dhe të DAR/ZA-ve, me mësues dhe me drejtues shkollash etj.
- U hartua një fishë për zbatimin e nismës “Tri lëndë në gjashtë orë”. Fisha jepte sqarime rreth menaxhimit të orarit mësimor, planifikimit mësimor, organizimit të orës së mësimi, vlerësimit të nxënësit dhe plotësimit të dokumentacionit shkollor.
- U hartuan modele të organizimit të orarit për klasat kolektive.
- U trajnuan të gjithë specialistët e DAR/ZA-ve për zbatimin e nismës në shkollë.
- U diskutuan me rrjetet profesionale lëndore mënyrat e zbatimit të nismës “Tri lëndë në gjashtë orë” dhe u sugjeruan orë mësimi model (me dy orë të njëpasnjëshme, 45 +45 minuta) duke regjistruar edhe 25 video për orë të tilla mësimore.
- U trajnuan drejtuesit e rrjeteve profesionale për hartimin e planeve mësimore vjetore, planeve të periudhës dhe planeve ditore në udhëzuesit kurrikularë lëndorë, në kuadër të zbatimit të nismës “Tri lëndë në gjashtë orë”.

1.1.5 Nisma “Bëjmë detyrat e shtëpisë në shkollë”

Nisma “Bëjmë detyrat e shtëpisë” është një program, i cili u ofrohet të gjithë nxënësve të institucioneve arsimore në të cilat zbatohet kjo nismë. Ky program synon:

- sigurimin e kushteve dhe të mundësive të barabarta për nxënie për të gjithë nxënësit dhe krijimin e një mjedisi gjithëpërfshirës që mbështet dhe nxit progresin e çdo fëmije;
- përmirësimin e arritjeve të nxënësve, përmes sigurimit të kohës, hapësirës dhe programeve shtesë që ofrohen pas mësimit për të gjithë nxënësit, duke i ndihmuar ata në kryerjen e detyrave të shtëpisë;
- nxitjen dhe zhvillimin e interesave dhe prirjeve të nxënësve në fusha të caktuara përmes aktiviteteve jashtë kurrikulare që organizon shkolla;
- përmirësimin e klimës dhe zhvillimin e frymës së bashkëpunimit në shkollë;
- mbështetjen e familjeve dhe zhvillimin e partneritetit me prindërit dhe anëtarë të tjerë të komunitetit, për t’iu përgjigjur sa më mirë përmbushjes së nevojave fizike, emocionale dhe sociale të nxënësve, si dhe për të garantuar zhvillimin e tyre të shëndetshëm.

Përgjatë vitit shkollor 2017- 2018, nisma “Bëjmë detyrat e shtëpisë” u pilotua në 20 institucione arsimore të pesë drejtorive arsimore rajonale, ndërsa në vitin shkollor 2018-2019 kjo nismë u shtri në rreth 90 institucione arsimore në të gjithë vendin. Për zbatimin e kësaj nisme, si gjatë fazës së pilotimit ashtu dhe përgjatë zbatimit masiv të saj, nga MASR u ngrit grupi teknik për zbatimin e nismës, në përbërje të cilit kishte dhe specialistë të IZHA-s, të cilët krahas koordinimit dhe monitorimit të veprimtarive në disa prej shkollave të përfshira në nismë, u angazhuan në mënyrë të veçantë për hartimin e udhëzuesit për zbatimin e nismës “Bëjmë detyrat e shtëpisë”, i cili është një material ndihmës për institucionet arsimore dhe institucionet arsimore vendore, përgjegjëse për arsimin parauniversitar, të përfshira në zbatimin e nismës.

1.1.6 Analiza e vlerësimit të kurrikulës së AMU-së dhe të AML-së

 *Vlerësimi i brendshëm* i kurrikulës së zbatuar është konsideruar nga ASCAP një proces tepër i rëndësishëm. Monitorimi dhe vlerësimi i vazhdueshëm është parë si një funksion i brendshëm i hartuesve të saj me qëllim:

- identifikimin e përvojave pozitive;
- përcaktimin e vështirësive dhe të problematikave në zbatimin e saj; dhe
- mbështetjen e shkollave në këtë proces.

 *Gjatë procesit të pilotimit të kurrikulës së arsimit bazë*, nga ASCAP janë kryer monitorime dhe vlerësime të vazhdueshme përmes vizitave dhe takimeve në shkolla, përmes vëzhgimeve të orëve mësimore dhe këshillimeve me mësues dhe drejtues, përmes anketimeve me pyetësorë të drejtpërdrejtë dhe online etj. Këto vlerësime janë përfshirë në raportin kombëtar “*Perceptimi i mësuesve dhe i prindërve mbi cilësinë e reformës së arsimit parauniversitar në Republikën e Shqipërisë*”, MASR dhe IZHA, 2017.

 *Gjatë viteve shkollore 2018-2019 dhe 2019-2020*, ASCAP ka realizuar analizën e vlerësimit të brendshëm të kurrikulës së zbatuar të AMU-së dhe të AML-së. Kjo analizë ka synuar:

- mbështetjen dhe këshillimin e vazhdueshëm të mësuesve dhe të drejtuesve në procesin e zbatimit të kurrikulës;
- evidentimin e përvojave pozitive dhe shpërndarjen e këtyre përvojave;
- identifikimin e problematikave që dalin përgjatë zbatimit të kurrikulës dhe përcaktimin e strategjive për përmirësimin e tyre.

 Nga analiza e vlerësimit të brendshëm të kurrikulës së zbatuar dhe të të dhënave të mbledhura përmes pyetësorëve, vëzhgimeve dhe bisedave me mësues, drejtues shkollash, drejtues rrjetesh profesionale, kryetarë të ekipeve lëndore etj., rezulton se:

-
- Zbatimi i kurrikulës me bazë kompetencat në institucionet arsimore të AMU-së dhe të AML-së ka sjellë ndryshime të rëndësishme pozitive në kuptimin e filozofisë kurrikulare dhe zbatimin e praktikave pedagogjike që lidhen me planifikimin kurrikular, metodologjitë e mësimdhënies/nxënies dhe vlerësimin e nxënësve.
 - Mësuesit dhe drejtuesit e shkollave kanë krijuar përvoja të suksesshme, në mënyrë të veçantë për sa i takon përdorimit të metodave, teknikave dhe strategjive të të nxënësve që nxisin interesin, gjithëpërfshirjen, ndërveprimin dhe punën kërkimore të nxënësve.
 - Trajnimet e vazhdueshme nga specialistët e kurrikulës dhe aktorë të tjerë, me fokus të veçantë përdorimin e teknikave dhe strategjive që nxisin të menduarin kritik dhe krijues, zgjidhjen e problemeve etj., sikurse dhe botimet që ASCAP ka përgatitur në ndihmë të zbatimit të kurrikulës, kanë mbështetur punën e mësuesve në përdorimin e teknikave që zhvillojnë aftësi të niveleve të larta të të menduarit.
 - Zbatimi i kurrikulës shoqërohet me sfida të cilat adresojnë mbështetjen në mënyrë të vazhduar të zhvillimit të mëtejshëm profesional të mësuesve në fusha të tilla, si: vlerësimi i nxënësve, plotësimi i nevojave të nxënësve me nevoja të veçanta, përdorimi i TIK-ut etj. Përmirësimi i komunikimit ndërmjet aktorëve dhe i rolit të drejtuesve të shkollave në zbatimin e kurrikulës me bazë kompetencat janë aspekte që kanë nevojë të përmirësohen dhe të mbështeten më tej.

II. ZHVILLIMI PROFESIONAL I MËSUESVE

Procesi i të nxënit është në qendër të reformave të sistemit arsimor parauniversitar, kjo do të thotë që zhvillimi profesional i mësuesve është prioritet njësoj i të dyja sistemeve: *i) i formimit fillestar të mësuesve, ii) i zhvillimit të vazhdueshëm profesional të tyre*. Kurrikula e reformuar e arsimit parauniversitar vë kërkesa specifike përballë mësuesit. Nga njëra anë nevojitet rishikimi i përmbajtjes dhe i organizimit të kurrikulës së formimit fillestar të mësuesve nga institucionet e arsimit të lartë për të formuar mësues që janë në gjendje të zbatojnë një kurrikul të re, nga ana tjetër nevojitet mbështetje e vazhduar e mësuesve në sistem për zbatimin e kësaj kurrikule, për të lehtësuar sa më shumë të nxënit dhe për ta bërë atë sa më cilësor dhe efektiv.

2.1 Formimi fillestar i mësuesve

Bazuar në ligjin nr. 80/2015, datë 22.07.2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në Republikën e Shqipërisë”, si dhe në kushtet kur kurrikula e reformuar e arsimit parauniversitar vë kërkesa specifike përballë mësuesit, *nevojitet rishikimi i përmbajtjes dhe i organizimit të kurrikulës së formimit fillestar të mësuesve nga institucionet e arsimit të lartë* për të formuar mësues që janë në gjendje të zbatojnë një kurrikul të bazuar në kompetenca, që plotëson nevojat dhe interesat e nxënësit, që është fleksibël dhe që bazohet në burime të shumëllojshme të nxëni.

Sipas përcaktimeve në nenin 83 të ligjit të mësipërm, kurrikula e formimit fillestar të mësuesve përbëhet:

- nga formimi i përgjithshëm psiko – pedagogjik;
 - nga formimi shkencor i lëndës/profilit përkatës.
- a) Sipas këtij neni, formimi i përgjithshëm psiko-pedagogjik përbën 25% të të gjithë kurrikulës në ciklin përkatës të studimit, sipas profileve të mësuesve në arsimin parauniversitar. Në këtë kuadër të gjitha fakultetet e edukimit duhet të *njësojnë lëndët që do të zhvillojnë në këtë formim*, përmbajtja e të cilave duhet të jetë në të njëjtën linjë me kërkesat e arsimit parauniversitar për kompetencat e formimit të përgjithshëm të mësuesit.
- b) Në nenin 83, gjithashtu, përcaktohet se programet e ciklit të dytë të studimit që formojnë mësues *të së njëjtës lëndë/ profil të mësuesisë*, do të kenë së paku **80%** të kurrikulës me përmbajtje të ngjashme. Kjo kërkon që:
- ✎ së pari, të gjitha fakultetet e mësuesisë të të njëjtit profil të *njësojnë programin e studimit që formon mësues* për të njëjtën lëndë/profil;
 - ✎ së dyti, të gjitha fakultetet e mësuesisë të të njëjtit profil të *njësojnë në masën 80%, përmbajtjen e kurrikulës* (lëndët dhe rezultatet e të nxënit) për formimin e mësuesit *të së njëjtës lëndë/profil*, në të njëjtën linjë me kurrikulën e arsimit parauniversitar.
- c) Ligji i ri për institucionet e arsimit të lartë (IAL) mundëson *funksionimin efektiv të qendrave të ekselencës për trajnimin* e mësuesve. IAL-të në bashkëpunim me MASR-në dhe ASCAP-in do të hartojnë akte rregullatore për funksionim më të mirë të praktikave shkollore të studentëve të mësuesisë.

Gjatë kësaj periudhe janë realizuar:

- Përcaktimi i kriterëve të reja për mësuesinë nga universitetet.
- Rritja e notës mesatare 7.5, si kriter hyrës në programet e mësuesisë.
- Studimi për vlerësimin e kurrikulave të formimit fillestar të mësuesve.
- Rekomandimet për rishikimin e kurrikulave të formimit fillestar të mësuesve.
- Drafti për standardet e formimit fillestar të mësuesve.

- Përfshirja e tetë universiteteve shqiptare në projektin Erasmus+ “Zhvillimi i kompetencave të mësuesve për një sistem gjithëpërfshirës të zhvillimit profesional të mësuesve” dhe krijimi i *qendrave të trajnimit të mësuesve* në universitetet shqiptare.

2.2 Zhvillimi i vazhdueshëm profesional i punonjësve arsimorë

Zhvillimi i vazhdueshëm profesional i punonjësve arsimorë orientohet dhe rregullohet me dokumentet: ligji nr. 69/2012, datë 21.06.2012 “Për arsimin parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar; Strategjia e Zhvillimit të Arsimit Parauniversitar, 2014-2020; udhëzimi nr. 1, datë 20.01.2017 “Për funksionimin e sistemit të zhvillimit të vazhdueshëm profesional të punonjësve arsimorë”; raporti “Identifikimi i nevojave për trajnim të mësuesve dhe të drejtuesve”; urdhri “Për ngritjen e komisionit të akreditimit të programeve të trajnimit”, i ndryshuar.

Në legjislacion theksohet se mësuesit dhe drejtuesit trajnohen të paktën 3 ditë në vit dhe se trajnimet zhvillohen sipas sistemit “kërkesë - ofertë”, në bazë të nevojave të mësuesve dhe të ofertave nga agjenci trajnuese të akredituara.


Në këtë kuadër janë realizuar këto veprimtari:

 Është ndërtuar portali i ri: <https://trajnime.arsimi.gov.al>. Ky portal mundëson:

- transparencën e moduleve të trajnimit të akredituara;
- kalendarin e trajnimeve që do të zhvillohen nga agjencitë trajnuese;
- regjistrimin e të gjithë mësuesve që trajnohen nga këto agjenci;
- monitorimin dhe llogaridhënien e agjencive trajnuese për zhvillimin e trajnimeve;
- krijimin e databazës online të të dhënave për të gjithë mësuesit e trajnuar;
- vlerësimin e mësuesve për trajnimet e organizuara;

- transparencën e tarifës së kreditit, e cila është përcaktuar jo më shumë se minimalja e kreditit në ciklin e dytë të studimeve në IAL.

ASCAP ka trajnuar rreth 22 000 mësues për çdo vit shkollor.



Në kuadër të zhvillimit profesional të mësuesve janë ngritur rrjetet profesionale të mësuesve sipas profileve përkatëse apo sipas roleve të mësuesve në shkollë. Fuqizimi i rrjeteve profesionale të mësuesve ka qenë në vëmendje të veçantë të punës së ASCAP-it në procesin e zbatimit të kurrikulës me bazë kompetencat. Rrjetet profesionale të mësuesve për çdo lëndë janë furnizuar në mënyrë të vazhdueshme me materiale mbështetëse, shoqëruar me takime dhe trajnime për zbatimin e tyre. Aktualisht janë 1200 rrjete profesionale, të cilat janë trajnuar në mënyrë të vazhdueshme nga specialistët e ASCAP-it, për udhëzuesin e funksionimit të rrjeteve, për planifikimin e punës vjetore të rrjeteve, për mënyrën e raportimit, si dhe për tema përmbajtësore si: *zbatimi i kurrikulës me kompetenca, përfshirë edhe organizimin e mësimit me dy orë të njëpasnjëshme; zbatimi i kurrikulës në të gjitha klasat; metodologjia e mësimit; portofoli i të nxënësve; vlerësimi i nxënësve; hartimi i testeve; klasat kolektive; mësuesit ndihmës; trajnimi për mësuesit e TIK-ut; ekstremizmi i dhunshëm; lufta kundër substancave narkotike; dokumentacioni i arsimit parashkollor; udhëzuesit për situatën e krijuar nga pandemia COVID – 19; përdorimi i platformave të mësimit online etj.*

📁 Në kuadër të mbështetjes së ASCAP-it për zhvillimin profesional të mësuesve dhe të drejtuesve të shkollave kanë përfituar trajnime nga buxheti i shtetit dhe nga funksionimi i rrjeteve profesionale të mësuesve rreth *22000 punonjës arsimorë për çdo vit shkollor* duke mbuluar 51% të trajnimeve në sistemin e arsimit parauniversitar. Gjatë vitit 2020 janë shpërndarë *25000 certifikata vlerësimi* me kredite për module të akredituara dhe të zhvilluara nga ASCAP. Certifikatat me kredite janë shpërndarë për drejtuesit e rrjeteve profesionale, specialistët e ZVA-ve që kanë marrë pjesë rregullisht në trajnimet e ASCAP-it, si dhe anëtarët e rrjeteve profesionale që janë aktivë dhe të angazhuar në rrjetet e tyre profesionale.

- Lufta kundër dukurive të tilla, *si episode të dhunës apo përdorimi i drogave* në shkolla janë prioritet i MASR-së dhe i Ministrisë së Brendshme. Ministria e Brendshme ka filluar tashmë të zbatojë konceptin “Shkolla të sigurt”, me një vëmendje të posaçme në rritjen e sigurisë, si brenda ashtu edhe jashtë shkollës. Duke synuar rritjen e sigurisë nëpërmjet ndërveprimit dhe parandalimit, MASR në bashkëpunim me Ministrinë e Brendshme nëpërmjet marrëveshjes së firmosur mes palëve, kërkon të krijojë një qasje të re nëpërmjet projektit “Shkolla të sigurt - Oficerët e sigurisë në shkolla”. Aktualisht janë trajnuar nga ASCAP rreth *140 oficerë të sigurisë* në shkolla.
- Prioritet i rëndësishëm gjatë këtyre viteve ka qenë mbështetja e arsimit gjithëpërfshirës përmes ngritjes së kapaciteteve të mësuesve ndihmës që tashmë janë pjesë e qenësishme e sistemit tonë arsimor. Puna për këta mësues filloi me krijimin e rrjeteve profesionale të mësuesve ndihmës. Janë ngritur *61 rrjete profesionale, të cilat përfshijnë rreth 1067 mësues ndihmës në të gjithë vendin*.
- Një prioritet tjetër i rëndësishëm gjatë këtyre viteve është aftësimi i mësuesve për kompetencën digjitale. Janë krijuar platforma dhe janë trajnuar rreth *1200 mësues të TIK-ut* për përdorimin e këtyre platformave që kanë si qëllim përdorimin e përmbajtjeve digjitale në kuadër të kurrikulës me kompetenca, për përdorimin e TIK-ut në procesin e mësimdhënie – nxënies dhe për sigurinë

kibernetike. Në këtë kuadër është hartuar edhe platforma akademiale dhe janë trajnuar rreth 1200 mësues të TIK-ut për përdorimin e saj në mësimin online gjatë pandemisë COVID- 19.

2.3 Drejtuesit e rrjeteve të shkencave të natyrës

Bazuar në prioritetin e MASR-së dhe të ASCAP-it për organizimin e trajnimit të drejtuesve të rrjeteve profesionale të shkencave të natyrës, me temë *“Të nxënit me bazë kërkimin në mësimin e shkencave të natyrës. Zbërthimi i programeve lëndore në tekstet shkollore angleze”* janë realizuar veprimtaritë e mëposhtme:

- ✓ Hartimi i projektit të trajnimit të drejtuesve të rrjeteve të shkencave të natyrës.
- ✓ Hartimi i programit të trajnimit.
- ✓ Hartimi i moduleve të trajnimit për mësuesit e lëndëve: Biologji, Kimi, Fizikë.
- ✓ Hartimi i planit tematik të rrjeteve sipas profileve, për periudhën tetor 2019-qershor 2020 dhe shtator 2020 - qershor 2021.
- ✓ Përgatitja e kalendarit të trajnimit të rrjeteve për çdo ZVA.
- ✓ Trajnimi i drejtuesve të rrjeteve dhe monitorimi i tyre.

Konkretisht:

- U trajnuan 107 drejtues të rrjeteve profesionale të profileve biologji, kimi, fizikë dhe 200 specialistë të ZVA-ve. Trajnimi i rrjeteve u fokusua në zbatimin e programeve lëndore të biologjisë, kimisë, fizikës në tekstet e këtyre lëndëve; zbatimin e metodologjisë së bazuar në kompetenca; zbërthimin e aparatit pedagogjik të teksteve të reja të lëndëve të biologjisë, kimisë, fizikës sipas filozofisë mbi të cilën janë ndërtuar.
- U trajnuan nga drejtuesit e rrjeteve profesionale në nivel vendor, 1463 mësues, anëtarë të rrjeteve profesionale të shkencave të natyrës që japin mësim në klasat 6-9.
- U monitoruan takimet e rrjeteve profesionale të profileve biologji, kimi, fizikë për zbatimin e aftësive të fituara në procesin e mësimdhënie-nxënies.

Nëpërmjet kësaj faze u monitoruan planet e rrjeteve profesionale, takimet e rrjeteve, si dhe u vëzhguan mësues (anëtarë të rrjeteve të trajnuar) gjatë zhvillimit të orëve mësimore. Ky proces do të vijojë deri në qershor 2021.

2.4 Zhvillimi profesional i mësuesve të gjuhës shqipe e të letërsisë, si dhe të matematikës për vlerësimin e nxënësve që bazohet në kompetenca dhe për përgatitjen për provimet kombëtare të MSH-së

Gjuha shqipe, letërsia dhe matematika janë lëndët kryesore që ndikojnë në zhvillimin intelektual, shoqëror, estetik dhe emocional të nxënësve. Ato i pajisin nxënësit me njohuri, aftësi, vlera dhe qëndrime, të cilat janë përcaktuese jo vetëm për arritjet e tyre në çdo fushë dhe lëndë mësimore, por edhe për të qenë të suksesshëm në botën përtej shkollës.

ASCAP vazhdimisht ka pasur në vëmendje zhvillimin profesional të mësuesve të këtyre lëndëve, ndërkohë që edhe MASR e ka përcaktuar si prioritet, trajnimin e mësuesve të klasës XII për vlerësimin që bazohet në kompetenca, me fokus të veçantë përgatitjen e nxënësve për provimet kombëtare të MSH-së. Ky prioritet vjen si pasojë e rezultateve të maturantëve në këto provime. Në lëndët e mësipërme, nxënësit treguan se kishin vështirësi në trajtimin e pyetjeve me bazë kompetencat dhe situatat e të nxënit.

Bazuar në prioritetin e MASR-së dhe të ASCAP-it për trajnimin e mësuesve të gjuhës shqipe, letërsisë dhe matematikës, janë realizuar veprimtaritë e mëposhtme:

- Hartimi i projektit për trajnimin e mësuesve të gjuhës shqipe, letërsisë dhe matematikës që japin mësim në klasën XII.
- Hartimi i moduleve të trajnimit për mësuesit e profileve: Gjuhë shqipe e letërsi, Matematikë.
- Përgatitja e kalendarit të trajnimit, nga i cili do të përfitojnë:

- 709 mësues të gjuhës shqipe dhe të letërsisë, nga të cilët 572 mësues në arsimin publik dhe 137 mësues në arsimin privat;
- 682 mësues të matematikës, nga të cilët 539 mësues në arsimin publik dhe 137 mësues në arsimin privat.

Ky trajnim do të fillojë në janar 2021 dhe do të përfundojë në maj 2021. Trajnimi do të realizohet nga drejtoria e kurrikulës dhe e kualifikimit në ASCAP.

2.5 Funksionimi i komisionit të akreditimit të programeve/moduleve të trajnimit (KAPT), si dhe funksionimi i portalit

Gjatë vitit 2017 u ngrit për herë të tretë, komisioni i akreditimit të programeve të trajnimit (KAPT) bazuar në udhëzimin nr.1, datë 20.01.2017, të ministrit të Arsimit dhe Sportit “Për zhvillimin profesional të punonjësve arsimorë” dhe urdhrin e ministrit të Arsimit dhe Sportit, nr.75, datë 16.02.2017, “Për ngritjen e komisionit të akreditimit të programeve të trajnimit të punonjësve arsimorë në sistemin parauniversitar”, i ndryshuar.

Komisioni i përbërë nga përfaqësues të ASCAP-it dhe të MASR-së gjatë periudhës 2017-2020 ka kryer këto veprimtari:

- ka përgatitur planin e veprimtarive për procedurat e aplikimit, vlerësimit dhe akreditimit të programeve/moduleve të trajnimit, duke u bazuar në udhëzimin e zhvillimit profesional të punonjësve arsimorë dhe dokumentin “Shpallja e interesit për trajnimin e punonjësve arsimorë në arsimin parauniversitar, për periudhën 2017-2020”, miratuar me urdhër të ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë;
- ka përgatitur njoftimin e KAPT-it “Për paraqitjen e aplikimeve të programeve/moduleve të trajnimit për punonjësit arsimorë në sistemin e arsimit parauniversitar”;

- ka organizuar procesin e pranimit dhe të vlerësimit të programeve/moduleve të trajnimit, duke u bazuar në udhëzimin e zhvillimit profesional të punonjësve arsimorë;
- ka ndërtuar portalin: <https://trajtime.arsimi.gov.al>, në kuadër të përmirësimit të skemës së zhvillimit profesional të punonjësve arsimorë. Ky portal mundëson transparencën e moduleve të trajnimit të akredituara; kalendarin e trajnimeve që do të zhvillohen nga agjencitë trajnuese; regjistrimin e të gjithë mësuesve që trajnohen nga këto agjenci; monitorimin dhe llogaridhënien e agjencive trajnuese për zhvillimin e trajnimeve; krijimin e databazës online të të dhënave për të gjithë mësuesit e trajnuar; vlerësimin e mësuesve për trajnimet e organizuara; transparencën e tarifës së kreditit etj.
- ka përgatitur databazën e programeve/moduleve të akredituara, për periudhën dhjetor 2017- dhjetor 2021 (vendim nr.8, datë 11.12.2017 “Për akreditimin e moduleve të trajnimit”, i ndryshuar);
- ka akredituar *466 module trajnimi*, të cilat ofrohen nga *59 agjenci trajnimi*;
- ka përgatitur raportet vjetore të punës së tij për ministrin e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, për vitet 2017, 2018 dhe vitin 2019. Është në proces raporti i punës së KAPT-it për vitin 2020;
- ka ngritur grupet task- forcë për monitorimin dhe vlerësimin e punës së agjencive që kryejnë trajnime;
- ka përgatitur memo për ministrin e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, në lidhje me raportin e monitorimeve të agjencive trajnuese dhe për shkeljet e konstatuara;
- ka zhvilluar rreth 25 takime nga momenti i ngritjes së tij në shkurt të vitit 2017, deri në dhjetor 2020;
- është organizuar procesi i identifikimit të nevojave për trajnim të punonjësve arsimorë, ku paraqiten në mënyrë të përmblëdhur, sipas prioriteteve, fushat dhe çështjet kryesore të identifikuara si nevoja për zhvillim profesional të personelit arsimor, për periudhën 2021-2025.

Në vitin 2020, për shkak të situatës së krijuar nga pandemia COVID- 19, KAPT-i, në bazë të përgjegjësiave të tij funksionale dhe të kërkesave të agjencive të akredituara

për zhvillimin e trajnimeve online, ka marrë vendimin e mëposhtëm për mënyrën e zhvillimit të trajnimeve:

- *Modulet e akredituara me vendim të KAPT-it, të agjencive trajnuese përkatëse, për periudhën dhjetor 2017 – dhjetor 2021, janë akredituar për t'u zhvilluar me anë të trajnimeve të drejtpërdrejta. Për shkak të situatës së krijuar nga pandemia COVID-19, këto module të përshtaten për t'u zhvilluar online deri në një njoftim të dytë.*
- *Bazuar në prioritetet e MASR-së, gjatë situatës së krijuar nga pandemia COVID-19, do të zhvillohen vetëm module të akredituara që mbulojnë tematikat: Përdorimi i teknologjisë dhe i platformave digjitale në funksion të procesit mësimor; Zhvillimi i aftësive të nxënësve në fushën e shkencave të natyrës.*

Kalendari i trajnimeve dhe regjistrimi i mësuesve do të vijojë të zhvillohet njësoj në portalin: trajnime.arsimi.gov.al.

2.6 Trajnimi i mësuesve nga agjencitë e akredituara sipas portalit të trajnimeve

Bazuar në portalin trajnime.arsimi.gov.al, i cili menaxhohet nga RASH, kemi këto të dhëna:

- Gjatë vitit 2018 janë trajnuar 21750 mësues, nga të cilët 4414 mësues janë trajnuar nga IAL-të dhe 17335 mësues nga subjektet private.
- Gjatë vitit 2019 janë trajnuar 22145 mësues, nga të cilët 3829 mësues janë trajnuar nga IAL-të dhe 18316 mësues nga subjektet private.
- Gjatë vitit 2020 janë trajnuar 33895 mësues nga IAL-të dhe nga subjektet private.

Bazuar në të dhënat e portalit trajnime.arsimi.gov.al, në tabelën e mëposhtme pasqyrohet numri i mësuesve të trajnuar për çdo fushë, gjatë vitit 2020.

Fusha e trajnimit	Numri i mësuesve të trajnuar
Etika, komunikimi dhe pedagogjia (EKP)	11488
Mësimdhënia dhe të nxënit (MN)	6703
Planikimi i kurrikulës (PK)	6998
Çështjet ndërkurrikulare (ÇN)	2134
Drejtimi i shkollës dhe zhvillimi profesional i mësuesve (DRZHP)	2321
TIK-u në mësimdhënie dhe nxënie (TIK)	1575
TEAVET	2676
TOTAL	33895

2.7 Kualifikimi i mësuesve

Kualifikimi i mësuesve është proces i përvitshëm, i cili organizohet për mësuesit që plotësojnë vjetërsinë 5, 10 dhe 20 vjet punë dhe që kanë të drejtë të përfitojnë shkallët e kualifikimit:

2. Mësues Mjeshtër (kategoria I)
3. Mësues Specialist (kategoria II)
4. Mësues i Kualifikuar (kategoria III)

Në procesin e kualifikimit për vitin 2017 përfituan kualifikimin 2931 mësues të të gjitha cikleve dhe drejtues të shkollave të arsimit parauniversitar. Në vitin 2018 përfituan kualifikimin 2768 mësues. Në vitin 2019 përfituan kualifikimin 2597 mësues dhe në vitin 2020 përfituan kualifikimin 1836 mësues.

Puna për realizimin e kualifikimit të mësuesve përfshiu veprimtaritë e mëposhtme:

-
- Realizimi i *seancave informuese* me drejtues dhe me përgjegjës sektori të DAR/ZA-ve për procedurat e realizimit të kualifikimit, si dhe për udhëzimet e kualifikimit të mësuesve 2017, 2018, 2019 dhe 2020.
 - Hartimi i 22 programeve të kualifikimit të mësuesve sipas profileve përkatëse (gjithsej janë 88 programe kualifikimi).
 - Krijimi i databazës së të dhënave të mbi 11000 pjesëmarrësve në procesin e kualifikimit për 13 DAR-e dhe 25 ZA në tri vite: 2017, 2018, 2019, si dhe për 4 DRAP dhe 51 ZVA në vitin 2020.
 - Hartimi i 42 testeve të profileve të ndryshme për secilin vit (gjithsej 168 teste).
 - Vlerësimi i 3110 mësuesve në vitin 2017, 2950 mësuesve në vitin 2018, 2801 mësuesve në vitin 2019 dhe 2760 mësuesve në vitin 2020, mbi bazën e arritjeve në teste. Vlerësimi i mbi 11000 testeve u mundësua përmes angazhimit të rreth 100 mësuesve të përzgjedhur si vlerësues për çdo vit shkollor.
 - Certifikimi i mbi 10132 mësuesve dhe drejtuesve të të gjitha lëndëve në arsimin parauniversitar për përfitimin e shkallëve të kualifikimit.

2.8 Standardet profesionale të mësuesit dhe identifikimi i nevojave për trajnim të mësuesve

Standardet profesionale të formimit të përgjithshëm dhe të formimit lëndor të mësuesit në sistemin arsimor parauniversitar

Standardet profesionale për mësuesin janë pjesë përbërëse e një kuadri më të gjerë dokumentesh që përfshijnë të gjithë sistemin arsimor parauniversitar. Gjatë vitit 2020, nga ASCAP u hartuan “Standardet profesionale të formimit të përgjithshëm dhe të formimit lëndor të mësuesit në sistemin arsimor parauniversitar”.

Dokumenti i standardeve profesionale të mësuesit ka si qëllim kryesor të përshkruajë një vizion të ri për mësimdhënien, me fokus plotësimin e nevojave dhe të interesave individuale të nxënësit për dijen.

Këto standarde u hartuan përmes një procesi intensiv ekspertize, bashkëpunimi dhe konsultimi, nga një grup i gjerë ekspertësh të ASCAP-it, mësuesish dhe bashkëpunëtorësh të jashtëm të ASCAP-it, të cilët të koordinuar dhe në bashkëpunim ndërmorën një sërë veprimtarish:

- Konsultimi dhe diskutimi i dokumenteve dhe eksperiencave të mëparshme për hartimin e standardeve të mësuesit.

Në periudhat e mëparshme ishin hartuar drafte të standardeve të përgjithshme dhe lëndore të mësuesit, të cilat u konsultuan dhe u diskutuan. Grupet e ekspertëve konsultuan edhe përvoja të vendeve të tjera europiane apo botërore në këtë fushë. Të gjithë këto materiale të identifikuar u konsultuan dhe shërbyen si bazë për hartimin e dokumentit të ri.



- Përcaktimi i strukturës dhe i kriterëve përmbajtësore të dokumentit të standardeve.

Nëpërmjet bashkëpunimit mes grupit qendror dhe grupeve të punës, të ngritura për këtë rast u mundësua përcaktimi i një strukture si për standardet e formimit të përgjithshëm të mësuesit ashtu dhe për standardet e formimit lëndor. Në këtë mënyrë sot kemi një dokument lehtësisht të perceptueshëm dhe të përdorshëm nga të gjithë aktorët e interesuar.

- Hartimi i standardeve të formimit të përgjithshëm të mësuesit.

Kjo pjesë e standardeve përbën pjesën kryesore dhe më të rëndësishme të standardeve, e cila mund të përdoret nga të gjithë punonjësit arsimorë pavarësisht nga cikli shkollor dhe fusha kurrikulare ku janë të angazhuar.

- Hartimi i standardeve të formimit lëndor të mësuesit

Kjo pjesë e standardeve të mësuesit angazhoi një numër të madh ekspertësh dhe bashkëpunëtorësh, të organizuar në grupe, sipas formimit lëndor. Procesi i konsultimit dhe i hartimit u zhvillua në bashkëpunim dhe nën monitorimin e specialistëve të ASCAP-it.

- Miratimi i standardeve të formimit profesional të mësuesve.

MASR aprovoi dhe miratoi dokumentin “Standardet e formimit profesional të mësuesve” dhe e shpalli atë për të gjithë punonjësit arsimorë në vend. Dokumenti sot përbën pikën e referimit ku secili mësues mbështetet për të vlerësuar performancën e tij, duke dalluar anët e veta të forta dhe nevojat, si dhe për të kuptuar më mirë përparimin e tij profesional.

Identifikimi i nevojave për zhvillim profesional të punonjësve arsimorë në arsimin parauniversitar 2020

Bazuar në udhëzimin nr.1, datë 20.01.2017 të ministrit të Arsimit dhe Sportit për “Funksionimin e sistemit të zhvillimit të vazhdueshëm profesional të punonjësve arsimorë”, procesi i identifikimit të nevojave të punonjësve arsimorë bëhet çdo katër vjet. Ai është një proces që bëhet në bashkëpunim me DPAP-në, DRAP-et, ZVA-të, si dhe institucionet arsimore të arsimit parauniversitar. Siç duket, procesi është i gjerë dhe gjithëpërfshirës. Ai shtrihet në gjithë hierarkinë e institucioneve të sistemit arsimor parauniversitar, duke mundësuar një “skanim” tërësor të nevojave dhe të situatës në sistem.

Nisur nga prioritetet për katër vitet e fundit, ASCAP ndërmori punën për kryerjen e identifikimit dhe grumbullimit të nevojave për zhvillim profesional të mësuesve dhe drejtuesve. Për ta bërë sa më gjithëpërfshirëse këtë proces, u morën parasysh të gjithë aktorët e pranishëm në shkollë dhe që kontribuojnë në sistemin arsimor. Gjithashtu, për kryerjen e këtij procesi u morën parasysh edhe të dhënat e grumbulluara nga KAPT-i mbi ecurinë dhe llojshmërinë e aktiviteteve për zhvillim profesional, të ndërmarra gjatë katër viteve të fundit nga institucione partnere dhe agjenci trajnuese që kanë kontribuar në këtë fushë.

Qëllimi i procesit të identifikimit të nevojave ishte:

- Identifikimi i gjendjes reale të punonjësve arsimorë në sistemin arsimor parauniversitar për përmirësimin e aftësive, njohurive dhe shprehive të nevojshme.
- Evidentimi i fushave/çështjeve prioritare të nevojshme për të mbështetur zhvillimin profesional të punonjësve arsimorë.
- Rekomandimi i drejtimeve të ndërhyrjes dhe mbështetjes nga institucionet që mbështesin reformat në sistemin arsimor parauniversitar.
- Mbështetja e dokumenteve strategjike në fushën e arsimit parauniversitar për të siguruar ecurinë e duhur në fushën e reformave në arsim.

Veprimtaritë kryesore që u ndërmorën për ta mundësuar këtë proces janë:

- Hartimi i instrumentit për kryerjen e procesit të identifikimit të nevojave.

Instrumenti u ndërtua nga disa rubrika/fusha të identifikuara si kyç dhe të domosdoshme për zhvillimin profesional të mësuesve:

- Planifikimi dhe zbatimi i kurrikulës me kompetenca.
 - Mësimdhënia dhe të nxënit (Mësimdhënia dhe nxënia; Përkujdesja për nxënësit me vështirësi në të nxënë; Vlerësimi i të nxënit).
 - Etika dhe komunikimi (Etika dhe sjellja; Bashkëpunimi me komunitetin).
 - Gjithëpërfshirja për zhvillimin e shkollës.
- Aplikimi i instrumentit për identifikimin e nevojave.

Aplikimi i instrumentit u mundësua përmes ofrimit online, në platformën google form. Kjo mundësoi vjeljen e të dhënave për të gjithë punonjësit arsimorë, si dhe përmbushi kriterin e standardizimit të tij për të gjithë institucionet arsimore në vend. Procesi ishte i gjerë dhe gjithëpërfshirës. Ai u shtri në të gjithë hierarkinë e institucioneve të sistemit arsimor parauniversitar, duke mundësuar një “skanim” tërësor të nevojave dhe të gjendjes në këtë moment të situatës në sistem.

Instrumenti iu vu në dispozicion të gjithë punonjësve arsimorë në vend dhe u arrit të plotësohesh nga mbi 60% e tyre. Kjo masë përbën një mostër shumë të besueshme për të kuptuar nevojat reale të mësuesve.

- Përpunimi dhe shpallja e nevojave të mësuesve

Të dhënat e grumbulluara u përpunuan në formën e një raporti të përgjithshëm duke prezantuar një sërë gjetjesh për secilin fushë të vlerësuar. Pas përpunimit të të gjitha gjetjeve, ASCAP shpalli listën e nevojave për zhvillim profesional të mësuesve në sistemin arsimor parauniversitar.

2.9 Teknologjia në procesin e mësimdhënie – nxënies

Teknologjia e Informacionit dhe e Komunikimit (TIK) ka transformuar çdo aspekt dhe fushë të jetës sonë. TIK ka ndikuar shumë në mënyrën e ofrimit të shërbimit arsimor, pasi ka potencialin t’u sigurojë nxënësve të mësuarin gjatë gjithë jetës, pjesëmarrjen e plotë në shoqëri dhe suksesin në jetën profesionale. Bazuar në dokumentin “Korniza europiane për kompetencën digjitale të mësuesve, DigComEdu¹”, në kornizën e kompetencës së TIK-ut për mësuesit (ICT CFT, version 3)² nga UNESCO, ASCAP ka hartuar:

- a) Analizën e kurrikulës së arsimit parauniversitar për përfshirjen e përdorimit të TIK në kurrikul, e cila përmban konkluzionet dhe rekomandimet përkatëse.
- b) Analizën e standardeve profesionale të mësuesit (të formimit të përgjithshëm dhe lëndor) për përdorimin e TIK-ut, e cila përmban konkluzionet dhe rekomandimet përkatëse.
- c) Draft-standardet profesionale të mësuesit për përdorimin e TIK-ut në procesin e mësimdhënie – nxënies.
- d) Udhëzuesin për përdorimin e TIK-ut në procesin e mësimdhënie - nxënies.
- e) Modulet dhe materialet për trajnimin e mësuesve:

- 📖 *Zbatimi i standardeve profesionale të mësuesit për përdorimin e TIK-ut*
- 📖 *Kompjuteri dhe lundrimi në internet*
- 📖 *TIK dhe mësimdhënia/nxënia*
- 📖 *Përdorimi i TIK-ut në zbatimin e kurrikulës dhe në vlerësimin e nxënësit*
- 📖 *Përdorimi i platformave online në procesin mësimor*
- 📖 *Qytetaria digjitale dhe siguria në internet në mjediset digjitale*

¹<https://ec.europa.eu/jrc/en/digcompedu>

²https://unesdoc.unesco.org/ark:/48223/pf0000265721_eng

Në këtë kuadër janë trajnuar rreth *1200 mësues të TIK-ut* për përdorimin e platformës akademi.al, si dhe *5508 mësues për përdorimin e platformave online në procesin mësimor*.

Gjithashtu gjatë periudhës 2017-2020 janë realizuar:

- Krijimi me MOODLE i platformës digitalplatform.al, me qëllim përdorimin e përmbajtjeve digjitale në kuadër të kurrikulës me kompetenca për lëndën e TIK-ut.
- Hartimi i manualit dhe krijimi i videove-tutoriale për të lehtësuar aksesimin e portalit dhe përdorimin e të dhënave të portalit.
- Trajnimi i 340 mësuesve të TIK-ut për të përdorur platformën digjitale.
- Krijimi i profilit të 64 shkollave që do të jenë pjesë e platformës.
- Trajnimi i specialistëve të qendrave rajonale, i drejtuesve dhe i mësuesve për përdorimin dhe menaxhimin e portalit.
- Trajnimi i 26 drejtuesve të rrjeteve profesionale për risitë e lëndës së TIK-ut, gjuhët e programimit, si dhe përdorimin e platformës digjitale.
- Realizimi i 30 videove-tutoriale për t'u ardhur në ndihmë mësuesve të gjimnazit në implementimin e gjuhëve të programimit si: JAVA, HTML, ADOBE FLASH, si dhe algoritmet.
- Përgatitja e një programi trajnimi, me orë mësimi konkrete për AMU-në dhe AML-në, për të realizuar orë mësimore interaktive.
- Përgatitja e një manuali për t'u shërbyer mësuesve të TIK-ut në gjimnaz për përdorimin e gjuhëve të programimit, shkëputur nga Code.org.
- Trajnimi i 120 mësuesve të TIK-ut në gjimnaze, për kodimin dhe programimin.
- Përgatitja e mësuesve të shkollave për të rritur sigurinë e fëmijëve nëpërmjet:
 - hartimit të rregullave në shkollë për të rritur sigurinë e fëmijëve në ambientet shkollore;
 - krijimit të videove nga nxënësit e shkollave për ndërgjegjësimin e sigurisë kibernetike;

- krijimit të rrjeteve të diskutimit për *cyber-bulling*;
 - krijimit të forumeve për t'u ardhur në ndihmë fëmijëve që mund të jenë pre e çdo lloj dhune.
-
- Realizimi i videove të shkurtra dhe i posterave nga fëmijët për fëmijët në kuadër të sigurisë kibernetike në shkollë.
 - Ndërgjegjësimi i gjimnazistëve nëpërmjet videove të krijuara nga vetë ata, në lidhje me sigurinë kibernetike.
 - Promovimi i punimeve të nxënësve nëpërmjet hedhjes online në digitalplatform.al të punimeve të krijuara nga vetë fëmijët.
 - Fuqizimi i rrjeteve profesionale të TIK-ut në rrethe.

III. PËRBALLIMI I SITUATËS SË KRIJUAR NGA TËRMETI I 26 NËNTORIT 2019, SI DHE NGA PANDEMIA COVID- 19.

3.1 Roli ASCAP-it në përballimin e situatës së krijuar nga tërmeti i 26 nëntorit 2019

Në zbatim të urdhrit nr. 569, datë 04.12.2019 “Për rifillimin e procesit mësimor” si dhe në mbështetje të punës së institucioneve arsimore për rifillimin e procesit mësimor pas tërmetit të datës 26 nëntor 2019, ASCAP ka përgatitur dy materiale:

1. *Udhëzuesi për zhvillimin e procesit mësimor në hotelet ku janë akomoduar fëmijët e zonave të dëmtuara nga tërmeti.*

Për zbatimin e këtij udhëzuesi, ASCAP trajnoi mësuesit, psikologët, oficerët e sigurisë, si dhe specialistët e DRAP Durrës dhe të DRAP Lezhë. Gjithashtu ASCAP mbështeti mësuesit me materiale mësimore ndihmëse, gjatë gjithë kohës që procesi mësimor u zhvillua në hotelet, ku qëndronin fëmijët dhe prindërit e tyre për shkak të dëmtimeve të shtëpive nga tërmeti.

2. *Udhëzuesi për rifillimin e procesit mësimor në shkollë pas tërmetit të 26 nëntorit në DRAP Durrës dhe në DRAP Lezhë.*

Në këtë material janë dhënë disa udhëzime në lidhje me realizimin e programit mësimor, pajisjen e nxënësve me tekste shkollore, procedurat e vlerësimit të nxënësve dhe procedurat e transferimit të nxënësve në funksion të përmbushjes së kërkesave të kurrikulës.

3.2 Roli ASCAP-it në përballimin e situatës së krijuar nga pandemia COVID- 19

Pandemia COVID-19 e konsideruar një sfidë e madhe globale, ndikoi në çdo aspekt dhe sektor të shoqërisë, përfshirë edhe arsimin. Për shkak të situatës së krijuar prej kësaj pandemie, MASR mbylli institucionet arsimore që nga data 9 mars 2020 dhe vendosi që nxënësit e klasave 1-11 të vijonin mësimin në distancë deri në datë 29 maj 2020. Nxënësit maturantë u kthyen në shkollë më 18 maj dhe vijuan mësimin në shkollë deri në datë 5 qershor. Provimet e MSH-së u zhvilluan gjatë periudhës 8-18 qershor, ndërkohë që provimet kombëtare të arsimit bazë për klasën e pestë dhe për klasën e nëntë nuk u zhvilluan.

Viti shkollor 2020-2021 filloi në të gjitha shkollat duke zhvilluar mësim në mjediset e shkollës, ndërsa në muajin dhjetor 2020, për shkak të përkeqësimit të situatës epidemiologjike, filloi zbatimi i skenarit të mësimin të kombinuar (online dhe drejtpërdrejt në shkollë).

Në kushtet e kësaj situate, ASCAP ka qenë një ndër aktorët kryesorë për përshtatjen dhe riorientimin e procesit të mësimdhënies dhe të nxënësve, si dhe ofrimin e mbështetjes për shkollat dhe njësitë arsimore vendore.

Gjatë situatës së krijuar nga pandemia COVID- 19, për t'u ardhur në ndihmë mësuesve, nxënësve dhe prindërve në zbatimin e kurrikulës, ASCAP:

- *Ka punuar dhe vijon të punojë për sigurimin e cilësisë së rreth 1000 videove të publikuara në RTSH -Shkolla.*
- *Ka hartuar dhe ka publikuar udhëzime për organizimin e mësimin në shkollë, zhvillimin e mësimin në kushtet e shtëpisë, metodologjitë e mësimdhënies dhe vlerësimin e nxënësve, në varësi të secilit skenar të parashikuar (informacion i detajuar është dhënë në rubrikën 1.4 të raportit).*
- *Ka rishikuar dhe ka përshtatur 20 programe orientuese të Maturës Shtetërore, duke rishikuar tematikat dhe njohuritë e zhvilluara nga nxënësit në kushtet e*

mësimit në shtëpi pas datës 9 mars 2020 (informacion i detajuar është dhënë në rubrikën 1.3 të raportit).

- *Ka zhvilluar sondazhe online me mësues dhe me prindër për të mbledhur nevojat dhe për të vlerësuar e monitoruar procesin mësimor të zhvilluar në kushtet e pandemisë.*
- *Ka hartuar temat mësimore të njësuara për të gjitha lëndët e klasave 1-12 dhe ka trajnuar njësitë arsimore vendore dhe rrjetet profesionale të mësuesve për zbatimin e tyre nga shkollat.*
- *Është ndërtuar platforma akademi.al për mësimin online dhe për publikimin e videove të orëve mësimore.*
- *Ka trajnuar 1200 drejtues të rrjeteve profesionale dhe 20000 anëtarë të rrjeteve profesionale dhe specialistë të DRAP-eve dhe ZVA-ve për organizimin e mësimit dhe zbatimin e skenarëve.*

IV. NGRITJA E KAPACITETEVE TË MËSUESVE NDIHMËS, TË SHËRBIMIT PSIKO-SOCIAL DHE TË OFICERËVE TË SIGURISË

4.1 Ngritja e kapaciteteve të mësuesve ndihmës

Prioritet i rëndësishëm i ASCAP-it, gjatë viteve 2017-2020, ka qenë mbështetja e arsimit gjithëpërfshirës përmes ngritjes së kapaciteteve të mësuesve ndihmës që tashmë janë pjesë e qenësishme e sistemit tonë arsimor. Puna për këto mësues filloi me krijimin e rrjeteve profesionale të mësuesve ndihmës. Veprimtaritë për përmbushjen e këtij objekti u kryen në kuadër të pjesëmarrjes në grupin e punës së ngritur nga MASR me fokus arsimin gjithëpërfshirës.

Pasi u grumbullua një databazë e mësuesve ndihmës në të gjitha DAR/ZA-të (sot DRAP-et dhe ZVA-të) e vendit, u ngritën rrjetet profesionale duke përzgjedhur në bashkëpunim me DAR/ZA-të një drejtues për secilin rrjet. Janë ngritur *61 rrjete profesionale*, të cilat përfshijnë rreth 1067 mësues ndihmës në të gjithë vendin.

Në bashkëpunim me MASR-në u konceptua një skemë apo platformë e zhvillimit profesional të mësuesve ndihmës. Kjo platformë përcakton format që do të përdoren për të mbështetur dhe trajnuar mësuesit ndihmës. Në platformë përfshihen edhe një listë tematikash/çështjesh që janë të nevojshme për t'u trajtuar me mësuesit ndihmës.

Për të pasur një rezultat real lidhur me nevojat e mësuesve ndihmës për zhvillim profesional u krye dhe monitorimi i gjendjes aktuale të mësuesve ndihmës. Për këtë u zhvillua një instrument/pyetësor, i cili është plotësuar nga mbi 500 mësues ndihmës në sistem. Pyetësori mblodhi një sërë të dhënash për formimin dhe gjendjen profesionale të mësuesve ndihmës.

Gjatë kësaj periudhe, ASCAP në bashkëpunim edhe me partnerë që kontribuojnë në këtë fushë, planifikuan dhe realizuan trajnimin e drejtuesve të rrjeteve profesionale të mësuesve ndihmës.

Në këtë proces u ndërmorën dhe u realizuan një sërë veprimtarish, si:

- Gjenerimi i ideve dhe evidentimi i eksperiencave në vend në lidhje me mbështetjen e edukimit të fëmijëve me aftësi të kufizuara, përmes mësuesve ndihmës.
- Ngritja e rrjeteve profesionale të mësuesve ndihmës në çdo DRAP dhe ZVA.
- Krijimi i databazës së rrjeteve profesionale të mësuesve ndihmës.
- Konceptimi i skemës apo i platformës së zhvillimit profesional të mësuesve ndihmës.
- Përgatitja e materialeve burimore në ndihmë të mësuesve ndihmës.
- Ngritja e kapaciteteve të drejtuesve të rrjeteve profesionale të mësuesve ndihmës.
- Monitorimi i veprimtarisë së rrjeteve profesionale të mësuesve ndihmës.

4.2 Ngritja e kapaciteteve të shërbimit psiko-social dhe të oficerëve të sigurisë

Shërbimi psiko-social

- Gjatë vitit 2019, me koordinimin e ASCAP-it dhe me bashkëpunimin e ngushtë të Fakultetit të Shkencave Sociale të Universitetit të Tiranës, u bë i mundur trajnimi i rreth 320 punonjësve të shërbimit psiko-social në shkolla, për ndihmën e parë psikologjike në rastet e fatkeqësive natyrore.
- Gjatë vitit 2020 u bë hartimi i programit orientues për psikologun shkollor, për procedurat e konkurrimit për njësinë e shërbimit psiko-social.

-
- Gjatë vitit 2020 u bë hartimi i fondit të pyetjeve për psikologun shkollor (261 pyetje me tri nivele vështirësie), për procedurat e konkurrimit për njësinë e shërbimit psiko-social.
 - Gjatë vitit 2020 u bë hartimi i programit orientues për punonjës social, për procedurat e konkurrimit për njësinë e shërbimit psiko-social.
 - Gjatë vitit 2020 u bë hartimi i fondit të pyetjeve për punonjës social (253 pyetje me tri nivele vështirësie, për procedurat e konkurrimit për njësinë e shërbimit psiko-social.
 - Në kuadër të zbatimit të programit “Edukimi shëndetësor me fokus: edukimi seksual si aftësi për jetën dhe krijimi i një mjedisi të sigurt në shkollë” për fuqizimin e kapaciteteve shkollore mbi zhvillimin e aftësive dhe të njohurive mbi fenomenin e abuzimit seksual, ASCAP gjatë vitit 2020, ka trajnuar 135 punonjës të shërbimit psiko-social.

Oficerët e sigurisë

- Gjatë vitit 2018 specialistët e ASCAP-it koordinuan pilotimin e oficerëve të sigurisë në 15 shkolla të AML-së, në qytetin e Tiranës.
- Gjatë vitit 2018 u hartuan dhe pilotuan formatet e raportimit për oficerët e sigurisë.
- Gjatë vitit 2019 janë trajnuar 135 oficerë sigurie mbi protokollet e punës së oficerit të sigurisë në shkolla.
- Gjatë vitit 2019 janë trajnuar 135 oficerë sigurie mbi formatet e raportimit dhe të dokumentit të punës së oficerëve të sigurisë.
- Gjatë vitit 2019 u mbështet hartimi i planeve vjetore të aktiviteteve dhe të veprimtarive për oficerët e sigurisë në shkolla (plane model).
- Në kuadër të zbatimit të programit “Edukimi shëndetësor me fokus: edukimi seksual si aftësi për jetën dhe krijimi i një mjedisi të sigurt në shkollë” për fuqizimin e kapaciteteve shkollore mbi zhvillimin e aftësive dhe të njohurive mbi fenomenin e abuzimit seksual, ASCAP gjatë vitit 2019, ka trajnuar 135 oficerë sigurie.

V. NGRITJA E SISTEMIT TË VLERËSIMIT TË PERFORMANCËS SË SISTEMIT TË ARSIMIT PARAUNIVERSITAR

Lidhur me ngritjen e sistemit të vlerësimit të performancës së sistemit të arsimit parauniversitar, ASCAP ka kryer veprimtaritë si më poshtë:

- Hartimi i manualit “Vlerësimi i performancës së sistemit arsimor parauniversitar” (*draft i përfunduar*).
- Hartimi i materialit “Metodologjia e vlerësimit të performancës së sistemit arsimor parauniversitar” (*draft i përfunduar*).
- Studimi “Mbi praktikat ndërkombëtare të menaxhimit të sistemit arsimor gjatë pandemisë COVID-19” (*studim i përfunduar*).
- Raporti i vlerësimit për shërbimin psiko-social në institucionet e arsimit parauniversitar (*raport i përfunduar*).
- Hartimi i manualit “Vlerësimi i performancës së institucioneve të arsimit parauniversitar, qendrore, rajonale dhe vendore” (*vijon puna për hartimin e draftit*).
- Raport vlerësimi për shërbimin e oficerëve të sigurisë në shkolla (*vijon puna me përpunimin e të dhënave*).
- Studimi “Mbi praktikat më të mira ndërkombëtare të menaxhimit të sistemit arsimor gjatë periudhës COVID-19”.

VI. FUQIZIMI I SIGURIMIT TË CILËSISË SË ARSIMIT PARAUNIVERSITAR

Lidhur me fuqizimin e sigurimit të cilësisë së arsimit parauniversitar, ASCAP ka kryer veprimtaritë si më poshtë:

a) Ka hartuar paketën e vlerësimit të cilësisë së shkollës e cila përmban dokumentet:

-  Korniza e vlerësimit të cilësisë së shkollës, ASCAP 2020
-  Udhëzuesi për vlerësimin e jashtëm dhe të brendshëm të shkollës, ASCAP 2020
-  Metodologjia e vlerësimit të jashtëm të shkollës, ASCAP 2020
-  Metodologjia e vlerësimit të brendshëm të shkollës, ASCAP 2020

b) Ka ngritur kapacitetet e specialistëve/inspektorëve të DPAP/DRAP/ZVA-ve

- ☺ Trajnimi i 154 punonjësve të DPAP-së, DRAP-eve dhe ZVA-ve për vlerësimin e cilësisë së shkollave nëpërmjet platformave të vlerësimit.
- ☺ Mentorimi i DRAP/ZVA-ve gjatë procesit të vlerësimit të institucioneve arsimore parauniversitare për masat e marra në fillimin e vitit shkollor 2019-2020, duke reflektuar në 80 raporte monitorimi.
- ☺ Trajnimi i 122 specialistëve/inspektorëve të DRAP-eve dhe ZVA-ve për dokumentet e paketës së vlerësimi të cilësisë së shkollës.

c) Ka realizuar vlerësimin e zbatimit të procesit të kartës së performancës së shkollës (KPSH), e cila kishte për qëllim:

- vlerësimin e plotësimit të treguesve të KPSH-së;
- vlerësimin e efektivitetit të përdorimit të të dhënave të KPSH-së në planifikimin e drejtimeve të përmirësimit, në nivel rajonal dhe institucional;
- përditësimin e KPSH-së me ndryshimet e kuadrit ligjor dhe reformat e ndërmarra në arsim;
- dhënien e rekomandimeve në lidhje me vazhdimësinë e zbatimit të KPSH-sëj nga të gjitha shkollat e arsimit parauniversitar.

Në këtë proces u përfshirë 90 shkolla në katër DRAP-et: Korçë, Fier, Durrës dhe Lezhë. Në këtë analizë janë dhënë të detajuara edhe përfundime dhe rekomandimet përkatëse.

d) Ka hartuar dokumentin “Standardet profesionale të inspektorit të institucioneve arsimore”

Standardet profesionale të inspektorëve të institucioneve arsimore parauniversitare, të hartuara për herë të parë në Shqipëri, unifikojnë profesionin e inspektorit në shkallë kombëtare dhe përcaktojnë se çfarë duhet të dijë, të kuptojë dhe të bëjë një inspektor efektiv. Ky dokument është hartuar në bashkëpunim me Shkollën e Drejtorëve.

e) Ka hartuar dokumentin “Korniza e vlerësimit të cilësisë së kopshtit”, e cila shtjellon përkatësisht:

- qëllimet e përgjithshme të kornizës së vlerësimit të cilësisë së kopshtit, elementet kryesore të kornizës (fushat e cilësisë, kriteret e cilësisë, treguesit e cilësisë, përshkruesit praktikë, shkallët e vlerësimit dhe trendi i rivlerësimit);
- si kryhet vlerësimi i jashtëm i kopshtit nga inspektorët/vlerësuesit;
- realizimin e procesit të vlerësimit të vlerësimit të brendshëm, i cili përmban mbledhjen e të dhënave, hartimin e raportit të vlerësimit të brendshëm,

planin e përmirësimit dhe monitorimin e zbatimit të planit të përmirësimit të kopshtit;

→ formate model për palët e interesuara për zbatimin e kornizës së vlerësimit të cilësisë së kopshtit.

f) Është në proces hartimi i dokumentit “Manuali i riskut”

Ky dokument përcakton treguesit që duhen përdorur për të përcaktuar faktorët e riskut me të cilët ekspozohen institucionet arsimore gjatë kryerjes së veprimtarisë mësimore dhe edukative. Administrimi i riskut është një faktor kyç për arritjen e vizionit dhe misionit të institucioneve arsimore.

Në këtë manual shpjegohen metodat dhe procedurat për identifikimin, klasifikimin dhe vlerësimin e riskut, me të cilat institucionet arsimore janë të ekspozuara apo potencialisht mund të ekspozohen në të ardhmen.

g) Ka hartuar listat e verifikimit për sistemin “e-inspektimi”

Në kuadër të koordinimit të punës mes ASCAP-it, DPAP-së dhe Inspektoratit Qendror për zhvillimin e inspektimeve online nëpërmjet portalit “e-inspektimi”, drejtoria e vlerësimit të cilësisë në ASCAP ka hartuar dhe ka dërguar tek Inspektorati Qendror 16 lista verifikimi të akteve ligjore e nënligjore të arsimit parauniversitar, përkatësisht listë verifikimi për:

1. Ligjin 69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.
2. Rregulloren për funksionimin e institucioneve arsimore parauniversitare në Republikën e Shqipërisë.
3. Udhëzimin nr. 8, “Për kriteret dhe procedurat e kualifikimit të mësuesve”.
4. VKM-në nr. 600, “Për miratimin e shërbimit të sigurisë publike në 150 institucione të arsimit parauniversitar dhe të kriterëve për oficerët e sigurisë”.

-
5. Udhëzimin nr. 25, “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisë së nxënësve”, i ndryshuar me udhëzimin nr. 22, datë 04.10.2019.
 6. Udhëzimin nr. 12, “Për mbledhjen, përpunimin dhe mbrojtjen e të dhënave personale të punonjësve arsimorë dhe nxënësve në institucionet arsimore të sistemit parauniversitar, përmbajtjen e dosjeve të tyre personale, si dhe për mbledhjen, përpunimin dhe mbrojtjen e të dhënave kontaktuese të prindërve/kujdestarëve ligjorë të nxënësve”, i ndryshuar me udhëzimin nr. 28, datë 07.09.2018.
 7. Udhëzimin nr. 26, “Për mësuesin ndihmës për nxënësit me aftësi të kufizuara në institucionet publike të arsimit parauniversitar”.
 8. Udhëzimin nr. 17, “Për procedurat e ndjekjes së arsimit të detyruar nga nxënësit që nuk kanë ndjekur të paktën dy klasa të arsimit bazë dhe për arsimimin me kohë të pjesshme në arsimin bazë”.
 9. Udhëzimin nr. 13, “Për procedurat e pranimit e të emërimit të mësuesit në një vend të lirë pune në institucionet arsimore publike të arsimit parauniversitar dhe për administrimin e portalit “Mësues për Shqipërinë””.
 10. Udhëzimin nr. 30, “Për numrin e nxënësve për klasë dhe normat e punës mësimore në institucionet e arsimit parauniversitar”.
 11. Udhëzimin nr. 25, “Për ngritjen dhe funksionimin e bordit të institucionit arsimor”.
 12. Udhëzimin nr. 2, “Për procedurat e emërimit, pezullimit dhe shkarkimit të drejtorit të institucionit publik të arsimit parauniversitar”, i ndryshuar.
 13. Udhëzimin nr. 44, “Për përcaktimin e kriterëve dhe të procedurave të njëvlershmërisë së dëftësve dhe diplomave të nxënësve të arsimit parauniversitar, të ardhur nga jashtë vendit”, i ndryshuar.
 14. Udhëzimin nr. 34, datë 16.11.2018, “Për ndalimin e telefonit celular në IAP”.
 15. Udhëzimin nr. 1, datë 20.01.2017 “Për funksionimin e sistemit të zhvillimit të vazhdueshëm profesional të punonjësve arsimorë”.

16.Urdhrin nr. 313, datë 20.10.2020, “Për organizimin dhe funksionimin e shërbimit psiko-social në institucionin arsimor parauniversitar dhe procedurat e emërimit, pezullimit dhe largimit në shërbimin psiko-social”

h) Ka koordinuar punën me DPAP-në, DRAP-et dhe ZVA-të për vlerësimin e shkollës

Në kuadër të koordinimit dhe të integritit të punës mes ASCAP-it, DPAP-së, DRAP-eve dhe ZVA-ve për vlerësimin e shkollës, ASCAP ka hartuar 30 platforma për vlerësimin e cilësisë së shërbimit që ofron shkolla në lidhje me tematikat e mëposhtme:

1. Përzgjedhja/shpërndarja/shitja e teksteve shkollore
2. Plan afatmesëm dhe plani vjetor i shkollës
3. Planet vjetore lëndore/ të periudhave
4. Rregullorja e brendshme e shkollës
5. Regjistrimet, ndarja e klasave, norma mësimore
6. Zbatimi i nismës “Tri lëndë në gjashtë orë”
7. Vlerësimi i plotë i shkollës
8. Vlerësimi i arritjeve nga drejtuesit
9. Psikologu/punonjësi social dhe oficeri i sigurisë
10. Ngritja dhe funksionim i organizmave të shkollës
11. Mospërdorimi i celularëve
12. Nisma “Bëjmë detyrat e shtëpisë”
13. Vlerësimi i nxënësve
14. Karta e performancës së shkollës
15. Vetëvlerësimi i shkollës
16. Arritjet e nxënësve në provimet kombëtare
17. Veprimtaritë plotësuese (kalendari i veprimtarive)
18. Mjediset fizike të shkollës
19. Mësuesi ndihmës në nivel ZVA-je

- 20.Mësuesi ndihmës në nivel shkolle
- 21.Dokumentacioni shkollor (amza, regjistra)
- 22.Shkollat si qendër komunitare në nivel ZVA-je
- 23.Shkollat si qendër komunitare në nivel shkolle
- 24.Mirëqenia e nxënësve dhe krijimi i mjedisit të sigurt në shkollë dhe përreth saj
- 25.Planet mësimore (sipas temave mësimore të miratuara nga MASR)
- 26.Masat e marra për zhvillimin e mësimi në mjediset fizike të shkollës
- 27.Masat e marra për zhvillimin e mësimi në mënyrë të kombinuar
- 28.Masat e marra për zhvillimin e mësimi vetëm në distancë
- 29.Ngritja dhe funksionimi i rrjetit profesional të mësuesve ndihmës
- 30.Ngritja dhe funksionimi i rrjeteve profesionale të mësuesve

i) Ka realizuar zhvillimin profesional të drejtorëve të shkollave

Gjatë periudhës tetor-dhjetor 2020, drejtorja e vlerësimit të cilësisë (DVC) ka trajnuar rreth 1000 drejtorë shkollash për zbatimin e paketës së vlerësimit të cilësisë së shkollës. Për trajnimin e drejtorëve, DVC-ja hartoi 4 module, përkatësisht:

Moduli 1: Korniza e vlerësimit të cilësisë së shkollës

Moduli 2: Udhëzuesi për vlerësimin e jashtëm dhe të brendshëm të shkollës

Moduli 3: Metodologjia e vlerësimit të jashtëm të shkollës

Moduli 4: Metodologjia e vlerësimit të brendshëm të shkollës.

VII. DIASPORA DHE PAKICAT KOMBËTARE

7.1 Regjistri i diasporës

Procesi për krijimin e regjistrit shtetëror të diasporës ka filluar në vitin 2019 dhe vijon edhe në vitin 2020. Në këtë kuadër, gjatë vitit 2019 janë kryer këto veprimtari:

- Shpallja e njoftimit, kriterëve dhe afateve për aplikim në regjistrin shtetëror të diasporës.
- Administrimi i dokumentacionit të aplikantëve.
- Shqyrtimi i aplikimeve të kandidatëve.
- Vlerësimi i dokumentacionit të kandidatëve.
- Krijimi i regjistrit dhe hedhja e të dhënave.

Në përfundim të fazës së vlerësimit të dokumentacionit për vitin 2019 rezulton se kanë aplikuar 79 kandidatë, prej të cilëve:

- ✓ 20 kandidatë kualifikohen me dokumentacion të rregullt në përputhje me kriteret e përcaktuara në urdhrin nr. 413, datë 26.07.2019, të ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë “Për përcaktimin e kriterëve për krijimin e regjistrit shtetëror të mësuesve të gjuhës shqipe e të kulturës shqiptare dhe dhënien e certifikatave për nxënësit në diasporë”.
- ✓ 59 kandidatë nuk përmbushin kriteret për kualifikim sipas përcaktimeve të bëra në urdhrin e mësipërm, pasi kanë mungesë dokumentacioni dhe dokumentacion të panoterizuar.

Procesi i krijimit të regjistrit shtetëror për vitin 2020 ka kaluar nëpër këto faza:

- Përgatitja e njoftimit për aplikim, si dhe afatet, kriteret dhe dokumentacioni që do të dorëzojnë kandidatët për t'u bërë pjesë e regjistrit.
- Shpallja në faqen zyrtare të ASCAP-it e njoftimit, kriterëve dhe afateve për aplikim në regjistrin shtetëror të diasporës.
- Administrimi i dokumentacionit të kandidatëve nga grupi i punës.
- Shqyrtimi i dokumentacionit të kandidatëve.
- Vlerësimi i dokumentacionit të kandidatëve.

Veprimtaritë në vijim janë:

- Hartimi i listës së mësuesve që plotësojnë kriteret e përcaktuara për t'u bërë pjesë e regjistrit shtetëror të mësuesve të gjuhës shqipe e kulturës shqiptare në diasporë dhe dërgimi për miratim në MASR.
- Njoftimi i kandidatëve që plotësojnë kushtet për t'u bërë pjesë e regjistrit shtetëror (pas miratimit të listës nga ministri), si dhe ata të cilët nuk plotësojnë kushtet për t'u bërë pjesë e regjistrit.
- Krijimi i regjistrit dhe hedhja e të dhënave të kandidatëve sipas formatit të përcaktuar në VKM nr.104, datë 28.02.2019.

7.2 Mbështetja dhe organizimi i seminarit të përvitshëm me mësues nga diaspora

Zhvillimi i seminarit të përvitshëm me mësuesit e diasporës është një traditë 15-vjeçare. Për zhvillimin e këtij seminari bashkëpunojnë dy ministrinë përgjegjëse për arsimin, në Shqipëri dhe në Kosovë. Synimet kryesore të seminarit janë që të mundësohet:

- mësim cilësor i gjuhës shqipe për fëmijët shqiptarë që jetojnë në diasporë;
- zhvillim profesional i mësuesve të gjuhës shqipe dhe të kulturës shqiptare në diasporë.

Për organizimin dhe zhvillimin e këtij seminari, MASR ngre çdo vit një komision pune, në të cilin ka përfaqësues nga MASR dhe nga ASCAP. Ky komision:

- harton njoftimin për abstraktet dhe punimet shkencore që mund të prezantohen në seminar;
- harton në bashkëpunim me palën kosovare, agjendën e seminarit;
- harton listën e pjesëmarrësve të seminarit;
- ndjek dhe zbaton procedurat e tenderave për mjediset ku do të zhvillohet seminari dhe ku do të qëndrojnë pjesëmarrësit;
- organizon zhvillimin e seminarit;
- harton raportin përfundimtar të seminarit.

Gjatë periudhës shtator 2017- 2020 janë zhvilluar dy seminare:

1. *Seminari XIV “Për mësimin plotësues në gjuhën shqipe në diasporë” u zhvillua në Tiranë, në datat 31.07.2018- 03.08.2018. Në këtë seminar morën pjesë 162 persona. Nga këta:*

- 130 ishin mësues të gjuhës shqipe në diasporë;
- 32 ishin lektorë dhe akademikë, si dhe specialistë të dy ministrive përgjegjëse për arsimin (MASHT dhe MASR), në Kosovë dhe në Shqipëri.

2. *Seminari XV “Për mësimin plotësues në gjuhën shqipe në diasporë” u zhvillua në Prizren, në datat 31.07.2019- 03.08.2019. Në këtë seminar morën pjesë 176 persona. Nga këta:*

- 154 ishin mësues të gjuhës shqipe në Gjermani, Kroaci, Itali, Greqi, Suedi, Zvicër etj.;
- 22 ishin lektorë dhe akademikë, si dhe specialistë të dy ministrive përgjegjëse për arsimin (MASHT dhe MASR), në Kosovë dhe në Shqipëri.

Seminari i vitit 2020 nuk u zhvillua për shkak të pandemisë COVID-19.

7.3 Pakicat kombëtare

Në shkollat e pakicave kombëtare, si në të gjithë sistemin arsimor shqiptar zbatohet kurrikula e bazuar në kompetenca. Gjatë periudhës 2017-2020 janë hartuar nga ASCAP, *45 programe mësimore lëndore*, ku përfshihen: gjuha amtare greke, gjuha amtare maqedonase, historia e Greqisë, historia e Maqedonisë, gjeografia e Greqisë, gjeografia e Maqedonisë, gjuha shqipe për pakicat kombëtare, gjuha e huaj për pakicat kombëtare. Programet e tjera mësimore janë të njëjta me shkollat e tjera të sistemit arsimor parauniversitar.

ASCAP, bazuar në nenin nr. 9 të VKM-së, nr. 227, datë 17.04.2019 “Për përgatitjen, shtypjen, botimin dhe shpërndarjen e teksteve shkollore të arsimit bazë për nxënësit e institucioneve arsimore publike parauniversitare, ku mësojnë nxënës të pakicave kombëtare” ka koordinuar hartimin dhe miratimin e *8 teksteve të reja shkollore* për pakicat kombëtare:

- Gjuhë amtare maqedonase, klasa IV.
- Gjuhë amtare maqedonase, klasa V.
- Gjuhë amtare maqedonase, klasa IX.
- Histori amtare e Maqedonisë, klasa IX.
- Gjuhë amtare greke, klasa IV.
- Gjuhë amtare greke, klasa V
- Gjuhë amtare greke, klasa IX.
- Histori amtare e Greqisë, klasa IX.

VIII. RRITJA E PARTNERITETIT DHE E BASHKËPUNIMIT ME INSTITUCIONE E ORGANIZMA TË TJERË QEVERITARË DHE JO QEVERITARË, TË BRENDSHËM E TË HUAJ, NË FUNKSION TË REALIZIMIT TË OBJEKTIVAVE TË POLITIKËS DHE TË REFORMËS ARSIMORE

8.1 Mbështetja teknike pranë MASR-së

ASCAP nëpërmjet specialistëve të saj ka mbështetur vazhdimisht MASR-në duke u angazhuar në grupe pune të përbashkëta si:

- Angazhimi në komisionin e vlerësimit të teksteve shkollore (KVTSH) për procesin e konkurrimit, vlerësimit dhe miratimit të teksteve të reja të klasës së pestë.
- Angazhimi në komisionin e akreditimit të programeve/moduleve të trajnimit (KAPT).
- Angazhimi në grupet e punës për PKIE, LGA, kapitullin 26.
- Hartimi i dy raporteve për tekstet falas në përdorim për klasat 1-4, pas monitorimeve të specialistëve të ASCAP-it dhe të MASR-së, si dhe vlerësimeve të bëra nga të gjitha drejtoritë dhe zyrat arsimore.
- Angazhimi në grupe pune në MASR për hartimin e akteve nënligjore.
- Angazhimi si anëtarë të bordeve në IAL.
- Pjesë e grupeve të punës, të ngritura me urdhër të kryeministrit për vlerësimin e teksteve me Greqinë.
- Monitorimi i provimeve të MSH-së.

- Monitorimi i “Shkollave të përkohshme” në Durrës, realizuar nga specialistët e DKK-së.

8.2 Bashkëpunimi me institucione dhe organizata të tjera

Në kuadër të zbatimit të reformës kurrikulare, të hartimit të dokumenteve kurrikulare, të ngritjes së kapaciteteve të punonjësve arsimorë, ASCAP ka pasur një sërë bashkëpunimesh me donatorë dhe organizata si më poshtë:

British Council

Bazuar në memorandumit e mirëkuptimit ndërmjet MASR-së dhe Këshillit Britanik, si dhe kontratës ndërmjet British Council dhe ASCAP (IZHA-s), programi “Shkollat e shekullit XXI”, financuar nga qeveria e Mbretërisë së Bashkuar, është organizuar dhe është zhvilluar nga ASCAP, me mbështetjen e MASR-së dhe Këshillit Britanik.

“Shkollat e shekullit XXI” është një program i shtrirë në të gjithë rajonin e Ballkanit Perëndimor, me një kohëzgjatje 3- vjeçare. Qëllimi i këtij programi është pajisja nxënësve të moshës 10-15 vjeç, me aftësi të menduarit në mënyrë kritike, të zgjidhjes së problemit dhe të kodimit. “Shkollat e shekullit XXI” iu mundësuan nxënësve të mësojnë në mënyrë zbavitëse, ndërvepruese dhe inovatore. Si pjesë e këtij programi do të shpërndahen rreth 23 500 *micro:bit*. Në këtë program do të trajnohen dhe do të mentorohen nga trajnerët kombëtarë, rreth 4.500 mësues.

Ky program është i ndarë në 5 cikle:

- Cikli i parë: mars- qershor 2019
- Cikli i dytë: shtator- dhjetor 2019
- Cikli i tretë: shkurt/mars- maj 2020
- Cikli i katërt: gusht/shtator- dhjetor 2020
- Cikli i pestë: shkurt/mars- maj 2021

Për shkak të pandemisë së krijuar nga COVID- 19, ciklet do të shtyhen deri në fund të vitit 2021.

Veprimtaritë për realizimin e këtij projekti:

☞ Janë certifikuar *40 trajnerë* për trajnimin e drejtorëve dhe të mësuesve të AMU-së.

☞ Janë akredituar 3 module trajnimi për drejtues, mësues dhe për përdorimin e micro:bit.

☞ Janë realizuar trajnimet:

☺ Në ciklin e parë: mars – qershor 2019, janë trajnuar 1078 drejtues dhe mësues

☺ Në ciklin e dytë: shtator – dhjetor 2019, janë trajnuar 1102 drejtues dhe mësues

☺ Në ciklin e tretë: janar – mars 2020, janë trajnuar 1103 drejtues dhe mësues

☺ Në ciklin e katërt: shtator – dhjetor 2020, janë trajnuar 586 drejtues dhe mësues

Aktualisht janë shpërndarë certifikata me kredite për pjesëmarrësit në ciklin e parë, të dytë dhe të tretë. Drejtuesit u pajisën me certifikatë me 1 kredit, ndërsa mësuesit me certifikatë me 2,5 kredite.

UNICEF

a) Në kuadër të programit “Qëndrueshmëria dhe zgjerimi i reformave në arsimin bazë – Objektivi “Njeriu dhe ndryshimet klimatike” IZHA (sot ASCAP) në bashkëpunim me UNICEF-in, gjatë periudhës 2017-2019:

- Ka ndërmarrë përgatitjen e *udhëzuesit “Edukimi për menaxhimin e emergjencave dhe sigurinë në shkollë”*. Udhëzuesi është konceptuar në formën e një materiali mbështetës për shkollat 9-vjeçare.
- Në 25 shkolla të pesë drejtorive arsimore (Tiranë, Durrës, Berat, Korçë, Lezhë), me fokus ngritjen dhe rivatilizimin e punës së komisioneve të

sigurisë në shkollë, janë zhvilluar trajnime të 150 anëtarëve të komisioneve të shëndetit, mjedisit dhe sigurisë për planifikimin dhe zhvillimin e veprimtarive ndërgjegjëse dhe përgatitore me nxënës, mësues, drejtues, psikologë dhe përfaqësues të komunitetit.

b) Në kuadër zhvillimit profesional të mësuesve të TIK-ut për përdorimin e kompetencës digjitale në procesin mësimor, ASCAP në bashkëpunim me UNICEF-in me mbështetjen e SDG FUND nëpërmjet financimit të qeverisë hollandeze, kanë ndërmarrë projektin “Ngritja e kapaciteteve të mësuesve për përdorimin e TIK-ut në procesin e mësimdhënie-nxënies”. Për realizimin e këtij projekti janë zhvilluar veprimtaritë si më poshtë:

- Analiza e kurrikulës së arsimit parauniversitar për përfshirjen e TIK-ut në kurrikul, e cila përmban konkluzionet dhe rekomandimet përkatëse.
- Analiza e standardeve profesionale të mësuesit (të formimit të përgjithshëm dhe lëndor) për përdorimin e TIK-ut, e cila përmban konkluzionet dhe rekomandimet përkatëse.
- Hartimi i draft - standardeve profesionale të mësuesit për përdorimin e TIK-ut në procesin e mësimdhënie – nxënies.
- Hartimi i udhëzuesit për përdorimin e TIK-ut në procesin e mësimdhënie - nxënies.
- Hartimi i moduleve dhe i materialeve për trajnimin e mësuesve:

 *Zbatimi i standardeve profesionale të mësuesit për përdorimin e TIK-ut*

 *Kompjuteri dhe lundrimi në internet*

 *TIK dhe mësimdhënia/nxënia*

 *Përdorimi i TIK-ut në zbatimin e kurrikulës dhe në vlerësimin e nxënësit*

 *Përdorimi i platformave online në procesin mësimor.*

 *Qytetaria digjitale dhe siguria në internet në mjediset digjitale.*

Në këtë kuadër janë trajnuar rreth 1200 mësues të TIK-ut për përdorimin e platformës akademi.al. Janë në proces trajnimet e mësuesve të TIK-ut për modulet e tjera të trajnimit.

- c) Në kuadër të vlerësimit të jashtëm të kurrikulës së AMU-së, ASCAP në bashkëpunim me UNICEF, nëpërmjet ekspertëve ndërkombëtarë u hartua raporti për vlerësimin e zbatimit të kurrikulës së AMU-ë, në të cilën u përcaktuan rekomandimet përkatëse për vijueshmërinë e reformës.

UNDP

MASR dhe ASCAP kanë vendosur si prioritet zhvillimin profesional të mësuesve ndihmës. Në këtë kuadër ASCAP ka ndërmarrë një projekt me fokus "*Edukimi i fëmijëve me aftësi të kufizuara*" i cili synon ngritjen e kapaciteteve dhe fuqizimin profesional të mësuesve ndihmës për të mbështetur fëmijët me aftësi të kufizuara. Ky projekt po zhvillohet në bashkëpunim me programin e UNDP "Leave No One Behind", i cili është i fokusuar në këtë fushë.

Në kuadër të këtij bashkëpunimi është hartuar një program trajnimi për mësuesit ndihmës nga ekspertë të fushës dhe po trajnohen 61 drejtuesit e rrjeteve profesionale të mësuesve ndihmës në të gjitha ZVA-të e vendit. Ky proces përfundon në shkurt 2021.

Titulli i programit është "*Edukimi i fëmijëve me aftësi të kufizuara, në ndihmë të mësuesve ndihmës në arsimin parauniversitar*".

Ambasada amerikane në Tiranë

ASCAP ka bashkëpunuar me ambasadën amerikane për:

- ngritjen e kapaciteteve të mësuesve të gjuhës angleze (390 mësues) dhe drejtuesve të rrjeteve profesionale të gjuhëve të huaja (60 drejtues) për zbatimin e kurrikulës dhe metodologjive të mësimdhënies;

- hartimin dhe akreditimin e dy moduleve të trajnimit;
- akreditimin e shtatë moduleve të trajnimit online me universitetet amerikane;
- trajnimin online të mësuesve të gjuhës angleze nga universitete amerikane (rreth 70 mësues dhe drejtues rrjetesh profesionale) për mendimin kritik, mësimdhënien e gramatikës në mënyrë komunikuese dhe përdorimin e teknologjisë;
- hartimin e dy manualeve trajnuese në mbështetje të mësuesve të gjuhës angleze me temë “Mësimdhënia me në qendër nxënësin” dhe “Fuqizimi i drejtuesve të rrjeteve profesionale”;
- trajnimin online të mësuesve të gjuhës angleze (rreth 200 mësues) për përdorimin e teknologjive online në mësimdhënie.

Këshilli i Europës

ASCAP ka bashkëpunuar me Këshillin e Europës dhe Qendrën Europiane të Gjuhëve Moderne në Graz për realizimin e dy seminareve me temë “Standardizimi dhe përshtatja e provimeve të gjuhës së huaj me Kuadrin European të Referencave për Gjuhët” (me 60 specialistë të arsimit).

Ambasada franceze

ASCAP ka bashkëpunuar me ambasadën franceze në Tiranë për realizimin e dy trajnimeve me mësues të shkollave të seksioneve dygjuhësore shqiptare – franceze, për metodat moderne në mësimdhënien e gjuhëve të huaja.

Korpusi i Paqes

ASCAP ka bashkëpunuar me Korpusin e Paqes për trajnimin e 3247 mësuesve në të gjithë Shqipërinë për masat që duhen marrë në raste fatkeqësish natyrore.

Save the Children

Gjatë periudhës mars-qershor 2020, MASR dhe ASCAP mbështetën mësuesit në përpjekjet e tyre për të zbutur ndikimin e mbylljes së menjëhershme të shkollave si pasojë e pandemisë COVID-19, si dhe për të mundësuar vazhdimësinë e procesit mësimor përmes mësimi në distancë (në kushtet e shtëpisë).

Falë kësaj mbështetjeje pjesa më e madhe e nxënësve vijoi me realizimin e njohurive dhe të aftësive që kërkon kurrikula, nëpërmjet mësimi në kushtet e shtëpisë. Megjithatë pati nxënës nga shtresat vulnerabël ose nga zonat e thella gjeografike, të cilët nuk mundën ta ndjekin mësimin në kushtet e shtëpisë. Sipas sondazheve të organizuara nga MASR dhe ASCAP, rezultoi se afërsisht 10000 fëmijë nga arsimi parauniversitar nuk kanë morën pjesë në këtë mësim.

Në një situatë të tillë, MASR dhe ASCAP, në bashkëpunim me Save the Children, hartuan një program plotësues për nxënësit e klasave 1-5, të cilët nuk arritën të ndjekin mësimin në kushtet e shtëpisë gjatë periudhës mars-qershor 2020. Qëllimi i këtij programi ishte pajisja e këtyre nxënësve me njohuritë dhe aftësitë gjuhësore dhe matematikore që i përkasin periudhës mars-qershor 2020. Programi u fokusua te gjuha shqipe dhe matematika, pasi këto lëndë zhvillojnë te nxënësit kompetencat më të rëndësishme, të cilat janë jo vetëm janë thelbësore për nxënien e të gjitha lëndëve në shkollë, por janë edhe kompetenca themelore për jetën.

Veprimtaritë e tjera që u realizuan për zbatimin e këtij programi janë:

- Hartimi i udhëzuesit në ndihmë të drejtuesve dhe të mësuesve për zbatimin e programit plotësues.
- Trajnimi i specialistëve të DRAP-eve dhe ZVA-ve, si dhe i drejtuesve të rrjeteve profesionale të arsimit fillor.

OEAD (ish Kultur Kontakt Austria)

Në kuadër të ngritjes së kapaciteteve të mësuesve dhe të specialistëve të zyrave dhe të drejtorive arsimore për përmirësimin e punës në përgatitjen dhe vlerësimin

e portofolit të nxënësit, ASCAP në bashkëpunim me KulturKontakt Austria, *gjatë periudhës 2017-2018* ka ndërmarrë zhvillimin e një sërë veprimtarive:

- ✎ Janë trajnuar 78 mësues të arsimit bazë, përfaqësues nga çdo fushë të nxëni, nga 26 shkollat pilot.
- ✎ Janë trajnuar 180 mësues të AML-së dhe rreth 50 specialistë të zyrave dhe të drejtorive arsimore.
- ✎ Janë përgatitur rreth 60 trajnerë, të cilët kanë shpërndarë trajnimin me 1393 mësues të shkollave të mesme.
- ✎ Është përgatitur udhëzuesi “Portofoli i të nxënit, instrument për vlerësimin e arritjeve të kompetencave të nxënësit”.
- ✎ Mësuesit e përgatitur si trajnerë kanë hartuar materiale me modele dhe shembuj detyrash të portofolit të nxënësit për të gjitha fushat e të nxënit.

Gjatë periudhës 2018-2020, në kuadër të bashkëpunimit të ASCAP-it me Kultur Kontakt Austria, për vlerësimin që bazohet në kompetenca, është realizuar:

- Trajnimi nga ekspertë ndërkombëtarë i 30 specialistëve, përfaqësues të ASCAP-it dhe të QSHA-së.
- Trajnimi nga specialistë të ASCAP-it i 78 mësuesve trajnerë në nivel lokal dhe në nivel shkolle, të cilët e kanë shpërndarë trajnimin me 2000 mësues, anëtarë të rrjeteve profesionale.
- Analiza e situatës mbi vlerësimin e nxënësve në kurrikulën e bazuar në kompetenca, në AMU.
- Hartimi i një “banke” me modele pyetjesh që matin zhvillimin e kompetencave për pesë fusha të nxëni në AMU. Kjo bankë pyetjesh është konsultuar dhe nga ekspertë ndërkombëtarë.

TEAVET (Erasmus+) – Zhvillimi i qendrave të trajnimit në institucione të arsimit të lartë.

Gjatë periudhës 2017-2020 MASR (ASCAP), 3 universitete të huaja dhe 8 universitete shqiptare kanë marrë pjesë në Erasmus+ për realizimin e projektit “Developing teacher competences for a comprehensive vet system in Albania - TEAVET (Erasmus+)”. Ligji për IAL-të mundëson *funksionimin efektiv të qendrave të ekselencës për trajnimin* e mësuesve. Në këtë kuadër MASR/ASCAP së bashku me 8 universitete shqiptare (Universiteti i Sporteve të Tiranës, Universiteti i Durrësit, Universiteti i Elbasanit, Universiteti i Gjirokastrës, Universiteti i Korçës, Universiteti i Shkodrës, Universiteti i Vlorës, Universiteti “Pavarësia” në Vlorë), si dhe 3 universitete evropiane (Universiteti “León” në Spanjë, Universiteti “Turku” në Finlandë, Danube University Crems në Austri), janë përfshirë në këtë projekt, i cili ka në fokus ***ngritjen e kapaciteteve të stafëve akademike*** të universiteteve shqiptare për trajnimin e mësuesve, si dhe ngritjen e sistemit të trajnimit nëpërmjet qendrave të të nxënësve gjatë gjithë jetës në këto universitete. MASR/ASCAP është përfshirë në orientimin e universiteteve për hartimin e moduleve të trajnimit (16 module trajnimi) në fushat: Të nxënësve digjital; Strategjitë e mësimdhënie/nxënies; Qytetaria aktive; Gjithëpërfshirja në arsim; Kultura e të nxënësve, Mediat e lexim-shkrimit etj.; si dhe në zhvillimin e trajnimeve të 1989 mësuesve në këto fusha.

Veprimtaritë për realizimin e objektivit:

- ☞ Nënshkrimi i memorandumit të mirëkuptimit midis tetë universiteteve dhe drejtorit të përgjithshëm të ASCAP-it për funksionimin e qendrës LLL.
- ☞ Përgatitja e planit të veprimit për paketën e punës 4.
- ☞ Këshillimi i universiteteve partnere gjatë zbatimit të kursit pilot.
- ☞ Implementimi i kursit pilot (3 muaj).
- ☞ Këshillimi i universiteteve partnere gjatë zbatimit të kursit pilot.
- ☞ Sondazh për mësuesit parauniversitarë dhe arsimtarët e mësuesve për të vlerësuar kurset pilot.
- ☞ Vlerësimi i kurseve pilot.
- ☞ Përpunimi i raportit të vlerësimit të kurseve pilot.

-  Fokus- grupe dhe takime për sistemin e trajnimit *LLL*.
-  Këshillimi i universiteteve partnere gjatë përgatitjes së kurseve të trajnimit.
-  Krijimi i bazës së të dhënave të regjistrimit të MASR-së (IZHA- sot ASCAP).
-  Vendosja e sistemit të akreditimit të MASR-së (IZHA- sot ASCAP).
-  Akreditimi i 16 moduleve të trajnimit
-  Realizimi i trajnimit të mësuesve

IX. KONFERENCA DHE PJESËMARRJE

Gjatë periudhës 2017 - 2020, ASCAP në bashkëpunim me MASR, MASHT (Kosovë), UNICEF, Junior Achievement etj., ka organizuar disa konferenca kombëtare si më poshtë:

- ✎ Gusht 2018 - Seminari XIV mbarëkombëtar *“Për mësimin plotësues në gjuhën shqipe në diasporë”*.
- ✎ Gusht 2019 - Seminari XV mbarëkombëtar *“Për mësimin plotësues në gjuhën shqipe në diasporë”*.
- ✎ Shtator 2018- Konferenca kombëtare me temë: *“Edukimi digjital në arsimin parauniversitar”* (në bashkëpunim me AADF dhe MASR).
- ✎ Tetor 2018 - Konferenca kombëtare me temë *“Nisma “Tri lëndë në gjasht orë”. Promovimi i organizimit të mësimit me dy orë të njëpasnjëshme”*.
- ✎ Tetor 2018 - Konferenca *“Arsimi parashkollor në fokusin e reformave arsimore”*.
- ✎ 2017 - 2020 - Aktivitete si anëtarë të rrjetit të CIDREE (Consortium of Institutions for development and research in education n Europe).
- ✎ 2017 - 2020 - Aktivitete si anëtarë të rrjetit ERISSE (Education Reform Initiative of South Eastern Europe).
- ✎ 2017 - 2020 - Aktivitete si anëtarë të rrjetit të Europena Training Foundation (ETF).
- ✎ 2017 - 2020 - Aktivitete si anëtarë të Këshillit të Europës.

X. STUDIME SHKENCORE DHE BOTIME

Gjatë periudhës 2017-2020, në kuadër të vazhdimësisë së reformës kurrikulare të arsimit parauniversitar, ASCAP ka përgatitur disa botime dhe ka kryer studime për çështje të caktuara.

ASCAP ka botuar periodikisht Revistën Pedagogjike, në të cilën përfshihen artikuj dhe studime të specialistëve të ASCAP-it, të specialistëve të arsimit të lartë, të mësuesve dhe të aktorëve të tjerë që sjellin përvojat e tyre në lidhje me zbatimin e kurrikulës, por dhe problematika të mësimdhënies dhe mësimnxënies. Pjesë e botimeve janë dhe përvojat, risitë e zhvillimeve arsimore në vende të ndryshme europiane e më gjerë. Më poshtë janë renditur disa prej tyre.

Studime

- ✎ ASCAP, 2020: Studimi kombëtar “Vlerësimi i brendshëm i kurrikulës së zbatuar të arsimit të mesëm të lartë (AML)”.
- ✎ ASCAP, 2019: Studimi kombëtar “Vlerësimi i brendshëm i kurrikulës së zbatuar të arsimit të mesëm të ulët (AMU)”.
- ✎ ASCAP, 2020: Analiza e perceptimeve të mësuesve, prindërve dhe nxënësve mbi mësimin online.
- ✎ ASCAP, 2020: Analiza e perceptimeve të mësuesve, prindërve dhe nxënësve mbi mësimin online.
- ✎ IZHA, 2017: Raporti kombëtar “Perceptimi i mësuesve dhe i prindërve mbi cilësinë e reformës së arsimit parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”.

Botime

- ✎ ASCAP, 2020: Revista Pedagogjike (RP), Education review, organ i ASCAP -it
- ✎ IZHA, 2018: Revista Pedagogjike (RP), Education review, organ i IZHA-s.
- ✎ IZHA, 2017: Revista Pedagogjike (RP), Education review, organ i IZHA-s.
- ✎ CIDREE, nëntor 2018, International approaches to STEM Education Conference - Learning mathematics through mathematical competences in preuniversity education in Albania.
- ✎ CIDREE, nëntor 2017, Wellbeing in our schools: international perspectives Conference - Teacher qualification- learning process for qualified teachers.
- ✎ CIDREE, nëntor 2016, Successful Approaches to Raising Attainment and Tackling Inequity Conference - The identification need of teachers and headteachers.

AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË SË ARSIMIT PARAUNIVERSITAR

Rruga "Naim Frashëri"
Nr. 37
Tirana
Shqipëri

(+355) 4256440 / 4256441

www.ascap.edu.al